



LEXIME
NË AJETET E HIXHRETIT



NËSE ALLAHU I KA PËRCAKTUAR
VEPRAT E MIA, ATËHERË PËRSE
MË MERR NË LLOGARI?



SUREJA EL-KEHF
DHE MËSIMET E SAJ

Viti 17 - Nr. 9 (199),
Shtator, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

13 HAFIZË TË KUR'ANIT I SHTOHEN VENDIT TONË



TURQIA, PAKISTANI DHE MALAJZIA ME KANAL TELEVIZIV KUNDËR ISLAMOFOBISË

Kryeministri i Pakistanit, Imran Khan ka deklaruar se Turqia, Pakistani dhe Malajzia kanë vendosur të krijojnë një kanal të përbashkët televiziv në gjuhën angleze për të luftuar me vështirësitë që paraqet islamofobia, transmeton Anadolu Agency (AA).

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, kryeministri i Malajzisë, Mahathir Mohamad dhe kryeministri i Pakistanit, Imran Khan zhvilluan një takim trepalësh në New York ku ata ndodhen në kuadër të Asamblesë së 74-të të Përgjithshme të OKB-së.



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

LEXIME NË AJETET E HIXHRETIT

(dredhitë). E kur atyre u lexohen ajetet Tona (Kur’ani), thonin: “Kemi dëgjuar (këso fjalësh) dhe sikur të donim edhe ne do të thonim diçka të ngjashme me këtë dhe se ky nuk është gjë tjetër veçse mit i lashtë”. Dhe (përkujto) kur thanë: “O All-llahu! Nëse është ky (Kur’ani) vërtet prej Teje, lësho gurë nga qielli kundër nesh, ose sillna ndonjë dënim të idhët”. Po All-llahu nuk do t’i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) je në mesin e tyre dhe All-llahu nuk do t’i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfar)”.

TË DASHUR TË PRANISHËM,

Krejt bota islame përkujton sot, ngjarjen e madhe të hixhretit të Resulull-llahut (a.s.) nga Meka, vendlindja e tij, drejt Medines së mikpritjes, zemërbardhësisë dhe begatisë së ndjerë në çdo hap, në çdo frymë, në çdo lutje.

Përpara duarve tona janë katër ajete të sures El-Enfal, rreth së cilave dua të ndërtoj hytben e kësaj jave, për të dalë tek mesazhet e Hixhretit dhe pasqyrimin e tij në realitetet tona shqiptare dhe ato të ymetit islam.

Si fillim, ajeti 30 i sures së lartpërmendur (El-Enfal), ndonëse është shpallur në Medine, bën fjalë për një ngjarje me shumë rëndësi. Dhe, siç thotë edhe dietari i shquar Shejkh Reshid El-Khatib (1303-1400 h.) në tefsirin e tij: “Përkujtimi i të Dërguarit (a.s.) me këto ngjarje mekase në periudhën medenite, na frymëzon për të kuptuar se ato ishin ndodhi të vështira me efekte të rëndat”.

Nga këtu, më lejoni të vendos para jush një përmbledhje të shkurtër të ngjarjes, që i parapriu hixhretit të Ma të Mirit të tanësisë, nga Meka drejt Medines.

“Kurejshitet u mblodhën fshehtas për të komplotuar që ta hiqnin qafe të Dërguarin e All-llahut. Në mes tyre u trajtuan këto tre mendime. Mendimi i parë u dobësua dhe ra, pasi e panë të pamundshëm. Poashtu edhe mendimi i tretë, për të cilin nuk ranë dakort, sepse kuptuan dhe vërtetuan se, nëse të Dërguarin do ta dëbonin, çështja e tij do të forcohej, për shkak të ëmbëlsisë dhe ndikimit të saj! Kështu, ranë dakort për mendimin e dytë. Do të merrnin nga një të ri energjik nga çdo fis dhe do të godisnin së bashku me shpatat e tyre, si një goditje e vetme. Kështu, gjaku i

tij (a.s.) do të përhapej në krejt fiset e Mekës dhe fisi i tij, Hashimët, nuk do të kishin mundësi të përballeshin me krejt fiset e përfshira në gjak dhe do të pranonin shpagimin e gjakut, të detyruar! Me këtë rast. Erdhi Xhibrili (a.s.) dhe e urdhëroi të Dërguarin që atë natë të mos flinte në shtratin e tij, ku flinte zakonisht dhe e vuri në dijeni me komplotin e parisë mekase. Kështu, All-llahu i Madhëruar i lejoi hixhretin, ku së bashku me Ebu Bekrin (r.a.), shoqëruesin e tij, u fshehën në shpellën e Theurit dhe prej aty u nisën drejt Medines.”.

TË DASHURIT E MI,

Ajo që kuptojmë nga këto ajete është, në krye të herës, “mirësia e veçantë (e All-llahut të Madhëruar) për të Dërguarin e Tij”, të cilin e mbrojti dhe e lartësoi, duke mbrojtur dhe lartësuar nëpërmjet tij krejt besimtarët dhe vetë fenë e Tij, deri në ditën e gjykimit!

“All-llahu e nxori të Dërguarin e Tij nga mesi i tyre, në atë mënyrë që ai të ishte i bindur ndaj Tij, në gjendje adhurimi ndaj Tij edhe në këtë dalje, që po ndodhte me urdhërin e Tij. Kështu, edhe dalja e tij do të ishte në një drejtim, ndryshe nga drejtimi që kishin planifikuar. Madje e quajti daljen e tij hixhret, që ta mësonin të gjithë se All-llahu i Madhëruar e dinte për komplotin e tyre ndaj tij, dhe që kjo ngjarje të ishte argument prej argumenteve të dërgesës dhe misionit të tij, pas largimit të tij nga mesi i tyre dhe ndarja e tij prej tyre, njësoj siç kishte argumente, ndërkohë që jetonte në mesin e tyre. Në këtë kontekst, ai është si Isai (a.s.), i cili kishte argumentet e dërgesës hyjnore, teksa jetonte në mesin e kundërshtarëve të tij, njësoj siç iu dha argument edhe lartësimi, pas largimit prej popullit të tij...”.

Nga këtu, muslimani duhet të bindet se, sa më shumë që rrugëton drejt Zotit të tij; sa më shumë që lidhet me fenë e tij; sa më shumë që e dëshmon frymën e besimit dhe moralin e tij në jetën e përditshme; sa më shumë që dëshmohej si ndërtues i jetës me vlerat islame; sa më shumë që dëshmohej si korrigjues i të keqes në shoqëri, me dritën e All-llahut dhe udhëzimin e Tij; sa më shumë që rrugëton drejt përhapjes së paqes me dinjitet, tolerancës me krenari,

dijes me përlulje, adhurimit të Një Zoti të vetë me të vërtetë me argument e bindje; sa më shumë që dëshmohej si përhapës i mrekullive të besimit me urtësi e mëshirë për krijesat e Zotit; aq më shumë do ta gjejë All-llahun e Madhëruar pranë vetes, edhe kur për një moment mund të mendojë se krejt bota i është vënë kundër dhe don ta izolojë, ta dëbojë a ta eliminojë!

Realitetet e botës tonë, na dëshmojnë sot, ditë pas dite, nevojën që ka njeriu i kësaj kohe për të lexuar drejtë e pastër Fjalën e Zotit, për t’u kthyer drejt Tij, për t’u paqtuar me Të, për t’u penduar nga jeta e shturrur, plot argëtim të paudhëzuar, plot haramë e pa kufij!

Realitetet e botës tonë, na frymëzojnë sot, që të mos lëmë pas dore asnjëherë mesazhet dhe udhëzimet që vijnë për ne nga leximi i drejtë i ajeteve të Hixhretit, por jo vetëm!

Një ndër tefsiret e ajetit: “Ata bënëin plane, e All-llahu i asgjësonte, se All-llahu është më i miri që asgjëson (dredhitë)”, është edhe kjo dëshmi, që na e sjell Imam Maturidi në tefsirin e tij: “Disa kanë thënë: Ata, (paria mekase; lexo: kundërshtarët e Islamit) nëpërmjet komplotit të tyre i deshtën të keqen (Pejgamberit dhe Islamit), që ishte përpjekja e tyre për ta shuar këtë dritë, që të shuhej kjo fé e të fshiheshin gjurmët e tij. Ndërsa All-llahu donte që një pjesë e tyre të bëheshin më vonë përkrahës dhe ndihmëtar të tij...”.

KËSHTU, TË DASHURIT E MI,

Nuk do të humbim kurrë shpresë, nuk do të rreshtim kurrë së punuari për këtë fé, nuk do ta thyejmë besën e All-llahut dhe Pejgamberit të Tij, do të vazhdojmë të thërrasim drejt kësaj feje, derisa të kemi frymë, nuk do të frikësohemi nga islamofobia dhe taborrat e Iblisit, që punojnë ditë-natë kundër kësaj feje dhe madhësisë së saj; atë e ka ruajtur dhe ruan All-llahu i Madhëruar, me a pa ne!

Ndërsa ne, teksa e rifreskojmë besën e All-llahut dhe besën e të Drëguarit të Tij, nuk bëjmë asgjë tjetër, veçse i përgjigjemi thirrjes së shenjtë kur’anore, me të cilën e nisa këtë hytbe: “Në mos e ndihmofshit atë (Pejgamberin), atë e ka ndihmuar All-llahu”!

Vel-hamdu lil-lahi rabbil-alemine!

(Hytbeja e mbajtur në xhaminë e “Dy Vajzave”, me rastin e përkujtimit të Hixhretit të Resulull-llahut (a.s.) dhe fillimit të vitit të ri 1441)

FALJE NGA TOKA, MËSHIRË NGA QIELLI..!

“U në u thashë: “Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë”. Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk...” – (Kur’ani, Nuh: 10-11).

Mjafton të meditojë njeriu në mirësinë e këtij fenomeni të mrekullueshëm, që i jep frymë e jetë natyrës, tokën e gjallëron e krijesat i fresko, për të kuptuar me prekje dashnie e përluljeje ndaj Zotit, madhësitinë dy ajeteve të lartpërmendura nga sureja e Hz. Nuhut (a.s.) dhe lidhjen e tyre në mes vete! Reshjet e shiut, si bekim e sinjal pastrimi e udhëzimi!

Në librat e tefsirit lexojmë se në kohën babait të dytë të njerëzimit, Hz. Nuhut (a.s.), shoqëria e humbi fillin e dritës e atë të udhëzimit. U dhanë pas tekave e epsheve, u zhytën në korrupsion e imoralitet, zhvatën e plaçkitën, gënjyen e mashtruan, ndonëse në mes tyre jetonte një i dërguar i Zotit, që përherë i tërhiqte vëmendjen, i ftonte në besim e udhëzim, i qortonte dhe i paralajmëronte se, rruga e hutimit dhe e neglizhencës ndaj Fjalës së Krijuesit dhe udhëzimit të Tij, nuk e lartëson njeriun në këtë jetë, as e madhëron shfaqjen e tij, si mëkëmbës i përzgjedhur i Zotit për të ndërtuar jetën mbi tokë, por... nuk dëgjuan, i kthyen shpinën, zunë veshët me duar për të mos e dëgjuar ligjërimin e tij..!?

Talleshin e përçmonin... E fyenin dhe e dëbonin..., deri një ditë, kur dikush u kujtua të trokiste në derën e të Dërguarit...

Kishin kaluar dyzet vite, që shterpësia e grave desh e humbi atë popull. Thätësira u bë e padurueshme, shkatërrimtare. Lumenjtë u thanë e bagëtia shko!

Atëherë, i durueshmi Nuh (a.s.) iu drejtua popullit të vet me këto fjalë të shpallura: “Unë u thashë: “Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë”. Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk, ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj. Ç’është me ju që All-llahu nuk i shprehni madhërinë që e meriton? Kur Ai ju krijoi në disa etapa. A nuk e keni parë se si All-llahu krijoi shtatë palë qiej (në kate). Dhe në ta hënë e bëri dritë, diellin e bëri ndriçues. Dhe All-llahu u shpiku juve prej tokës si bimë. Pastaj ju kthen në të, pa dyshim ju nxjerr sërish. All-llahu juve ua bëri tokën të sheshtë. Që nëpër të të ecni rrugëve të gjera”. – (Kur’ani, Nuh: 10-20).

Fare pak e lexuan si duhet mesazhin hyjnor; u penduan, u kthyen, falënderuan, ndryshuan jetën dhe shpëtuan zemrat nga vulosja me damkën e devijimit e shthurjes... E, shumica zgjodhi një rrugë ndryshe, fundi i së cilës ishte i pashpresë!

“Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë”. Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk, ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj. Ç’është me ju që All-llahu nuk i shprehni madhërinë që e meriton?”

Subhanallah, si është njeriu! Sa shpejt harron veten, familjen e tabanin! Sa shpejt harron origjinën, prejardhjen, Zotin! Sa shpejt hutohet e prish rendin..!

A nuk duhet të mendojë njeriu se si ndodh afrimi e bashkimi i reve, si funksionon reaksioni që krijohet deri në shkaktimin e nisjes së reshjeve, po format e larmishme të reshjeve: herë piklina e herë me furi, herë të ftohta e herë jo, herë lokale e herë gjithëpërfshirëse..?

A nuk duhet të ndjejë çdo pikë uji që zbret nga qielli, si një prekje mëshire e bekimi, që Krijuesi na dërgon, si për të na thënë se pendimi i dikujt, falja e kërkuar, përkushtimi e durimi në rrugën e Tij është pranuar?

A nuk duhet shijuar çdo piklinë e heshtur që zbret e pastër nga qielli, si një dhuratë dashnie, prej atyre që pranohen me zemër e shpirt, që nuk kthehen, as diskutohen, sepse përkunden në një djep Dashnie, që nuk njeh lëkundje, as tërheqje, as mëdyshje, as..?

Sot, bie shi. Tingujt që shkaktohen nga kontakti i tij me tokën, sikur shkruajnë mbi partiturat e heshtura të kësaj shfaqjeje madhështore: “Falje nga toka, mëshirë nga qielli”...

Si për të na ftuar përherë drejt reflektimit; pendimit e kthimit nga Zoti ynë, tek i Cili nuk ka zhgënjim, as dëshpërim dhe, nga i Cili pritët përherë mëshira dhe bekimet e grantuara, dyert e të cilave i hap kërkimi falje me zemër dhe vullneti për të ndryshuar drejt Tij...

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 23 shtator 2019

SYTARI: MË SHUMË JAM NDIKUAR NGA H. VEHBİ S. GAVOÇI; JA MESAZHET E TIJ PËR RININË, IDENTITETIN DHE HAXHIN

Redaksia e FOLDREJT ka arritur të intervistojë njërin ndër imamët më me ndikim në trevat shqiptare, Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari. Ai na flet për Haxhin, që mbledh sëbashku grupe të panumërta shoqërore, që në vendet nga kanë ardhur mund të kenë fërkime, por nuk ndodh asnjëherë në atmosferën e Haxhit. Kur kujtojmë burrat e mëdhenj të së kaluarës shqiptare, Sytari shpreh keqardhje që bijtë e tyre sot udhëhiqen nga një klasë politike që ka pranuar me pompozitet gjuhën e “integritetit të shqiptarëve”, sepse shqiptarët janë të Besës, nëse nuk devijojnë nga tabani i identitetit të tyre!

Foldrejt.com: Dëshëm ta fillojmë me një pyetje rreth kushtit të pestë të Islamit. Çfarë ju la përshtypje nga Haxhi i fundit?

Muhamed B.Sytari: Fillimisht ju falënderoj për interesimin tuaj dhe dashamirësinë për të zhvilluar këtë intervistë.

Në përgjigje të pyetjes tuaj, fillimisht dua të theksoj se Islami është fé e ndërtuar mbi themele të forta, që e mbajnë njeriun të lidhur përherë me Zotin e tij, sikurse e nxisin në vazhdimësi për të qenë shembull i mëkëmbësit real të Krijuesit të gjithësisë mbi tokë.

Më fjalë të tjera, në themelet e Islamit gjendet e mishëruar shumë mirë thirrja për të respektuar dhe ndjekur urdhrin e Zotit dhe nxitja për të mëshiruar krijesat e Tij.

Nga këtu, edhe eksperiencat e udhëtimit të Haxhit sillen rreth këtij përkufizimi të dalë nga hulumtimet dhe studimet e thella të fesë islame. Nuk është krejt e lehtë të përmbledhësh përshtypjet e Haxhit me pak fjalë. Në përfundim të Haxhit të vjetshëm shkrova një libër që e titullova: “Lebbejke..!”, që mendoj se është një pikë e mirë referimi për leximin dhe perceptimin e këtij udhëtimi dhe adhurimeve që lidhen me të.

Sivjet (sikurse edhe më parë), më ka bërë përshtypje dhe më mbush me shpresë dhe mirësi fryma e vëllazërimit dhe bashkëpunimit në mesin e njerëzve, mirëkuptimi dhe toleranca e dëshmuar në krejt hapat e këtij adhurimi, që mbledh mbi 2 a 3 milion njerëz nga mbarë bota në një periudhë të shkurtër kohore.

Ke parasysh, janë grupe të panumërta shoqërore, që vijnë nga lindja e perëndimi, duke mbartur me vete kultura e tradita, zakone e sjellje, që mund edhe të ndikojnë në një farë mënyrë në shfaqjen e ndasive, konflikteve a fërkimeve në mesin e tyre, por nuk ndodh kështu në atmosferën e Haxhit. Asnjëherë nuk ndodh!

I sheh njerëzit të shkrirë në NJË, aty përpara Qabes së Madhnueshme,

duke u lutur e duke kërkuar mëshirën e All-llahut. Ndihmohen në mes vete, shkëmbejnë buzëqeshje e lutje, i lirojnë vendin njëri-tjetrit, shpërndajnë mirësi e paqe, pa fund! Është një pamje e mrekullueshme, gati-gati në kufirin mes reales dhe ireales!

Nëse duam kthimin e vërtetë tek All-llahu, detyrim e kemi të mësojmë shkencat e ndryshme, të spikasim në veprat që kryejmë, të lartësohemi me sjelljen tonë, me përkushtim e korrektësi, si dhe me sinqeritet ndaj All-llahut; fshehtas dhe haptas! All-llahu i Madhëruar thotë në Kur’anin Famëlartë: “Ata që nuk besuan, shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e All-llahut”. Po muslimanët, a e shpenzojnë pasurinë e tyre për të udhëzuar nga All-llahu?”.

I sheh të tërhequr drejt dritës së besimit, të cilin e dëshmojnë pa ndrojtje e pa siklete, teksa luten e renden në tavafet e tyre, si grupet e zogjve që shtegtojnë nga një vend në tjetrin në kërkim të sigurisë, klimës së përshtatshme për jetë e për të ruajtur trashëgiminë e jetës.

Edhe haxhilerët, teksa sillen në tavaf, sikur i japin besën All-llahut të Madhëruar për të vazhduar të jenë njerëz besimtarë, mëshirues, ndërtues të jetës,

përhapës të paqes, të bardhë në zemër e sjellje, si ngjyra e rrobës që kanë veshur, të zotuar e me vullnet të fortë për të ndjekur gjurmët e Hz. Ibrahimit (a.s.), njeriut me besim të jashtëzakonshëm e me karakter të fortë, që nuk u përkul përpara asgjëje në jetë; as dhunës, as persekutimit, as vetë shejtanit!

Më bën përshtypje të madhe, momenti kur njerëzit afrohen tek vendi i quajtur: “Rukni Jemani”, prej ku përsërisin në vazhdimësi ajetin kur’anor: “Zoti ynë na jep të mira në këtë botë dhe të mira në jetën e përtejme dhe na mbro nga dënimi i zjarrit”!

Ky moment më jep një shije të veçantë, sepse të gjithë lutemi që Zoti të na japë të mira në këtë jetë, poashtu edhe në tjetrën. Me fjalë të tjera, Kur’ani na frymëzon dhe na thërret që të arrijmë më të mirën në këtë jetë, qoftë në dije, qoftë në shkencë, qoftë në ekonomi, qoftë në moral, qoftë në humanizëm, qoftë në garancinë që dhurojmë me sjelljet dhe veprat tona, qoftë në modelet pozitive që japim në jetë, secili në fushën e tij.

Kështu duhet ta kuptojmë këtë pjesë të ajetit. Ndërsa pjesa tjetër është plotësuese e pjesës së parë. Që do të thotë se, nëse unë si besimtar musliman e kam jetuar jetën time duke u ruajtur nga devijimi dhe shthurja, nga imoraliteti dhe padija, nga ekstremizmi dhe dhuna, nga arroganca dhe padrejtësia dhe, njëkohësisht kam ndërtuar vlera dhe mirësi nëpërmjet pozitës ku më ka vendosur Zoti në jetë (këtu mund të paramendosh me dhjetëra e qindra profesione), atëherë rrugëtimi im është drejt xhenneteve të All-llahut, për të cilat i lutem që të më bëjë pjesë e tyre! Një njeri që kërkon “të mira në jetën e përtejme dhe na mbro nga dënimi i zjarrit”, nuk mund të arrijë këtë gradë e shpërblim, pa e dëshmuar veten në këtë jetë si të denjë për xhennetet e Zotit të tij! Pra, ky moment është një përkujtim i mirë për t’u kthyer nga Zoti.

Më vijnë ndër mend këtu mësimet e Hoxhës tonë rahmetli, kryemyftiut të Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro, që

thoshte: “Kthimi tek All-llahu nuk është thjeshtë një fjalë që e themi, si zgjidhje e realiteteve tona! Kthimi tek All-llahu do të thotë kalim nga injoranca në dije, transferim nga përçarja në njësim, kthim nga armiqësia dhe urrejtja në dashamirësi dhe dashuri! Përderisa armiqësitë, urrejtja, veprat e ulëta, përgojimi, gënjeshtria dhe sjellja e keqe ndodhen në mes nesh, kjo do të thotë se, kthimi ynë tek All-llahu është thjeshtë një dëshirë ëndërrimtare: “... ata nuk ndjekin tjetër vetëm se hamendësime, e hamendësimi nuk vlen asgjë ndaj së vërtetësi!”.

Nëse duam kthimin e vërtetë tek All-llahu, detyrim e kemi të mësojmë shkencat e ndryshme, të spikasim në veprat që kryejmë, të lartësohemi me sjelljen tonë, me përkushtim e korrektësi, si dhe me sinqeritet ndaj All-llahut; fshehtas dhe haptas! All-llahu i Madhëruar thotë në Kur’anin Famëlartë: “Ata që nuk besuan, shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e All-llahut.”. Po muslimanët, a e shpenzojnë pasurinë e tyre për të udhëzuar nga All-llahu?”.

Foldrejt.com: Në lidhje me shqiptarët me maxhorancë muslimane dhe me vendndodhjen e tyre në perëndim. Si e shihni identitetin e sotëm shqiptar?

Muhamed B.Sytari: Fillimisht, më duhet të ndalem tek kjo pyetje e të shpjegoj se, përgjatë historisë, identiteti islam i shqiptarëve ka qenë përherë një element qytetërues dhe një kartë identiteti e pastër e dinjitoze, nëpërmjet së cilës shqiptarët janë njohur kudo nëpër botë si njerëz të urtë, të qytetëruar e kontribues të mëdhenj në mbrojtjen e vlerave dhe përhapjen e tyre.

Mos të harrojmë se për shekuj e shekuj, arnautët kanë drejtuar botën. Kanë qenë ministra e kryeministra, dijetarë e shkencëtarë, artistë e ushtarakë, arkitektë e udhëheqës me famë botërore, që kanë dhënë një kontribut të madh edhe në përhapjen e dritës së dijes e qytetërimit, edhe në botën perëndimore.

Në këtë kontekst nuk duhet të harrojmë emra të ndritur, si: Gjedik Ahmet Pasha, Ahmet Pashë Dukagjini, Lutfi Pasha, Koxha Sinan Pasha (pesë herë kryeministër i Perandorisë Osmane), Haxhi Halil Pashë Shqiptari, Arkitekt Sinani, Gjeneral Hajredin Barbarosa, Hoxha Tahsini, Sami Frashëri, Nezim Frakulla, etj.

Janë emra të shumë kryeministrash,

Ne nuk kemi nevojë të integrohemi, jemi të barabartë në mesin e popujve e kombeve, sepse kemi vlerat dhe historinë tonë, trashëgojmë një histori të madhe, që nuk duhet të lejojmë të na mbulohet e të na largohet nga vëmendja, sipas orekseve dhe propagandave që e duan kombin tonë, këtu ku ndodhet sot, fatkeqësisht!

gjeneralësh, shkencëtarësh, poetësh, mendimtarësh e udhëheqësish shpirtërorë, që përhapën vlera kudo nëpër botë!

Kur i kthehesh kësaj historie të lavdishme dhe dëgjon sot, sa djathtas-majtas thirrje për “integrimin e shqiptarëve”, ndjej një keqardhje të madhe se përse lidërshipi politik dhe klasa intelektuale shqiptare e pranon këtë gjuhë komunikimi me kombin e këtyre burrave të mëdhenj, që edhe Evropës i dhanë dritë e dije, pastërti e qytetërim!

Ne nuk kemi nevojë të integrohemi, jemi të barabartë në mesin e popujve e kombeve, sepse kemi vlerat dhe historinë tonë, trashëgojmë një histori të madhe, që nuk duhet të lejojmë të na mbulohet e të na largohet nga vëmendja, sipas orekseve dhe propagandave që e duan kombin tonë, këtu ku ndodhet sot, fatkeqësisht!

Prandaj, sa herë që përmendet Islami, shqiptarët duhet të ndjehen krenarë; muslimanët dhe të krishterët e tyre, sepse falë udhëzimeve dhe mësimave të këtij Islami burimor, krejt pakicat fetare janë respektuar dhe u janë dhënë të drejta edhe mbi të drejtat e muslimanëve, gjë për të cilën dëshmojnë faktet historike.

Mos të harrojmë se muslimanët shqiptarë ishin strehuesit e hebrejve në momente shumë të vështira për jetën e tyre, gjatë Luftës së Dytë botërore! Sepse muslimanët janë njerëz të Besës. Sepse shqiptarët janë të Besës, nëse nuk

devijojnë nga tabani i identitetit të tyre!

Ndërsa ajo që dëgjojmë sot, sidomos nga politikanë të ndryshëm, kur flasim për identitetin dhe fetë, këshilla ime për ta do të ishte: Mos e fetarizoni politikën dhe mos fusni hundët në diskursin fetar nga pozita e politikës, sepse çaloni dhe humbisni vlerën e pozitës që ju takon; bini nga syri dhe humbni peshën e pozitës!

Ne jemi muslimanë, aq sa jemi, sikurse dikush tjetër është i krishterë, aq sa është! Ne bashkëjetojmë për mrekulli, përderisa respektojmë njëri-tjetrin mbi baza sinqeriteti dhe përderisa nuk lejojmë të biem në batakun e servilizmit të politikave të lartpërmendura, që fetarizojnë politikën në dëm të kombit, të sotmes dhe të ardhmes së tij!

Foldrejt.com: Në kohën e monizmit shqiptarët privoheshin nga besimi, kurse sot në liri shohim një trend në rritje të largimit të njerëzve nga feja. Përse ndodh ky fenomen?

Muhamed B.Sytari: Do ta ndaj në dy pjesë pyetjen tuaj. Fillimisht përse i përket të kaluarës në diktaturë, ka dëshmi të shumta se si gjyshërit e baballarët tanë e ruajtën besimin dhe moralin e tyre, pavarësisht se nuk ishte aspak e lehtë të ruheshin disa ekuilibra në një kohë, kur frika, imponimi dhe angazhimi i njerëzve me një sistem të ri jete, sa vinte e rritej. Shtu këtu edhe mbylljen hermetike të vendit dhe varfërimin e individit dhe shoqërisë, përveç një klase të caktuar, sikurse dihet tashmë.

Pavarësisht kësaj, njerëzit nuk e lanë agjërimin fshehtas, nuk e lanë mësimin e sureve të shkurtra, nuk e lanë frikën e Zotit në punë e marrëdhënie me njerëzit, pavarësisht se sistemi ateist nxori femrën nga shtëpia, shkatërroi familjen, futi alkoolin dhe haramet në ushqim e pije, përhapit gënjeshtër dhe mashtrimin, luftoi fenë dhe shkatërroi infrastrukturën e saj, por jo vetëm. Pra, minosi bazamentet e vlerave dhe jetës së ndërtuar mbi pastërtinë dhe dashninë e Zotit!

Nga ana tjetër sot, mendoj se ka dy vështrime të gjendjes së shoqërisë shqiptare në raport me fenë. E para është dyndja e rinisë drejt xhamive dhe besimit, fakt që e dëshmojmë ditë pas dite në aktivitetin tonë fetar dhe thirrjen tonë për ruajtjen e identitetit, trashëgimisë historike dhe gjurmët qytetëruese të baballarëve. E dëshmojmë në ditën e xhuma, në ditën e bajramit, në muajin Ramazan, në udhëtimet përherë

5

në rritje drejt vendeve të shenjta për kryerjen e Umres dhe Haxhit, në rritjen e numrit të xhamive të reja, përherë në shtim, por jo vetëm.

E dyta është propaganda e madhe islamofobe, që lidhet edhe me ngjarje të mëdha të ndodhura në perëndim dhe gjendja aktuale e botës arabe dhe islame.

Pra, kemi në pamje të parë të rinj që vërshojnë drejt fesë së tyre, sikurse kemi edhe një propagandë dinake dhe të pamoralshme kundër Islamit dhe muslimanëve. Dhe në krye të kësaj propagande devijuese shohim dhe lexojmë emra të vjetër prej shërbestarëve besnikë të oborrit të diktaturës famëkeqe, si dhe bij të tyre besnikë, që vazhdojnë të vegjetojnë e të kërkojnë të spikasin në mediumet e ndryshme mediatiqe dhe rrjetet sociale me këtë që është sot, trend i kohës; islamofobia! Për këta kemi mëshirë dhe lutemi t'i udhëzojë Zoti drejt mëshirës dhe dritës së Tij!

Një gjë është e sigurt, sikurse shkruan edhe dijetari i shquar bashkëkohor, Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi në tefsirin e tij të Kur'anit: "Njeriu më ahmak dhe më budalla, është ai që hyn në një hendek prej ku sulmon dhe kundërshton të vërtetën!? Sa njerëz në këtë botë janë munduar ta shuajnë Islamin dhe ta eliminojnë atë; vdiqën e shkuan dhe Islamin vazhdon" e do të vazhdojë!

"Ka një sulm të madh që i drejtohet fesë, pas shpine! ... Rruga që kanë vizatuar për muslimanët, është largimi dhe distancimi nga feja e tyre dhe rregullat e saj, eliminimi i simboleve dhe emblemave! Kërkohet që të angazhuarit në shoqërinë islame, të jenë një model, pa ngjyrë, pa shije dhe pa erë. Një lloj, që nuk njihet për nga identiteti dhe ngjyresa fetare dhe ajo e moralit...!", siç shkruan Shejkh Muhammed Gazaliu, rahmet pastë.

Foldrejt.com: Çfarë rëndësie ka Hafiz Sabri Koçi për Shkodrën dhe Shqipërinë?

Muhamed B.Sytari: Hafiz Sabri Koçi i përket brezit të fundit të talebeve të hoxhallarëve të shquar shkodranë, si: H. Muhamed Bekteshi, H. Sheuqet Boriçi, H. Esat Myftija, etj.

Ai ishte pjesë e grupit të fundit të

përbërë nga 15 studentë, që morën ixhazet nga H. Muhamed Bekteshi në vitin 1952 dhe nisën rrugën e thirrjes, si imamë në xhami të ndryshme, kryesisht në fshatrat e Shkodrës, por në mes tyre kishte edhe nga Tetova, Ulqini, Elbasani, etj.

Pas daljes së tij nga burgu, në prag të rënies në dukje të diktaturës, u thirr të ishte në krye të besimtarëve muslimanë në ceremoninë e famshme të datës 16 nëntor 1990, te xhamia e Plumbit, ku qytetarët e Shkodrës e dëshmuar veten se besimi ishte aty, në zemrat e tyre, si fara e strukur në thellësinë e tokës, që mjafton pak ujë që ajo të nxjerrë kokën në kërkim të diellit e jetës!

Aty mbajti edhe fjalimin e tij të famshëm dhe drejtoi të xhumanë e parë masive, pas rënies së komunizmit, a në grahamat e tij të fundit.

E kam para syve fjalën e tij, sidomos kur thotë: "Neve kemi kenë t'penguem

tonë në Shkodër, menjëherë pas vitit 1990, për të na nxjerrë nga errësira në dritë, për të na kujtuar besën e shekujve, për të na zgjuar nga hutimi e nga gjendja e dëshpëruar ku ndodhej kombi në ato kohë!

Është pa dyshim një ndër shqiptarët më të mëdhenj të shekullit 20, si dhe dijetari më i spikatur shqiptar në botën islame, që dha një kontribut të madh në ruajtjen e traditës së pasur haneftë, por edhe si një shkollor i afirmuar gjithandej nëpër botë!

Sado të flas e të shkruaj për Zotninë e tij, nuk i dal borxhit, për mirësitë e tij ndaj nesh, fëmijëve të tij, kërkuesve të dijes, studentëve të parë të teologjisë jashtë Shqipërisë, pas vitit 1990!

Në verën e vitit 2002, pata mirësinë të rrij për një kohë të gjatë me Hafiz Sabri Koçin. Ishim vetëm për vetëm. Atë ditë e pyeta edhe për Hoxhën, H. Vehbi S. Gavoçi. Ndër të tjera më tha:

"Ai ka kontribuar për muslimanët shqiptarë me literaturë të ndryshme edhe para ndryshimeve demokratike në vendin tonë. Asokohe ka bërë disa botime me shumë vlerë për kosovarët. Megjithatë, ka pasur shumë pengesa dhe e kanë dëmtuar shumë herë! Jashtë atdheut e kam takuar dhe ishte

shumë i devotshëm dhe punëtor. Ka grumbulluar rreth vete fëmijë, burra e gra, duke mbajtur biseda, vasa e ligjërata të ndryshme, si e si ky popull të kthehet nga Zoti e feja. Gjithmonë kam kujtim të mirë për të... Në aspektin e ndihmesës së tij në literaturë fetare, Shejkh Vehbiu ka qenë jeta e Komunitetit Musliman Shqiptar! Veprat e tija të shumta, në një ambient të dominuar nga injoranca fetare dhe mungesa e intelektualëve islamë, ishin jetë! Ai e kishte kapur damarin aty, ku duhej. Ka bërë një shërbim të madh për ne, saqë ia kam zili atyre që janë njohur dhe kanë bashkëpunuar që herët me të...".

Pastaj, dua të përmend eruditin e pashoq, Shejkh Shuaib Arnautin, rahmet pastë. Një dijetar i spikatur, sidomos në lëminë e verifikimit të haditheve të Resulull-llahut (a.s.). Veprat e studiara, verifikuara e shpjeguara prej tij kalojnë kufijtë e logjikes, sidomos kur përmendim: verifikimin e Sahihul-

Këtu mund përmend hoxhallarët e nderuar: H. Sulejman Gavoçi, H. Jusuf Këlmendi, H. Ibrahim Kaduku, H. Ibrahim Repishti, Sheh Qazim Hoxha, H. Muhamed Bekteshi, H. Ali Kraja, H. Ali Korça, H. Ymer Bakalli, H. Ibrahim Dalliu, Salih ef. Myftia, Imam Vehbi Ismaili, etj.

Ishin burra të ditur, fetarë të shquar, atdhetarë të sprovuar, humanistë të lindur, fenerë të harmonisë fetare e kombëtare!

Bukhariut (24 vëllime), verifikimin e Sunen Ebi Davud (7 vëllime), verifikimin e Sunen Ebi Maxheh (5 vëllime), verifikimin e El-Xhamiul-Kebir të Imam Tirmidhiut (6 vëllime), verifikimin e Musnedit të Imam Ahmedit (44 vëllime), etj.

Kam pasur rast ta takoj e të marr ixhazet prej dorës së Zotnisë së tij. Rahmet pastë, sa njeri i madh dhe i thjeshtë njëkohësisht që ishte!

Do të përmend edhe disa emra të nderuar, pa hyrë në detaje të aktivitetit të tyre, që e kam hulumtuar dhe vazhdoj ta studioj. Janë burra të mëdhenj, që i vlerësoj dhe i kam pika referimi në aktivitetin dhe punën time.

Këtu mund përmend hoxhallarët e nderuar: H. Sulejman Gavoçi, H. Jusuf Këlmendi, H. Ibrahim Kaduku, H. Ibrahim Repishti, Sheh Qazim Hoxha, H. Muhamed Bekteshi, H. Ali Kraja, H. Ali Korça, H. Ymer Bakalli, H. Ibrahim Dalliu, Salih ef. Myftia, Imam Vehbi Ismaili, etj.

Ishin burra të ditur, fetarë të shquar, atdhetarë të sprovuar, humanistë të lindur, fenerë të harmonisë fetare e kombëtare!

Foldrejt.com: Në fund, çfarë këshille i jepni të rinjve, që shpesh janë mes pesimizmit dhe kërkimit të shpresës në BE dhe ShBA?

Muhamed B.Sytari: Të rinjtë janë bekim për shoqërinë! Të rinjtë janë

amaneti i Resulull-llahut (a.s.) dhe duhet të kemi shumë kujdes për ta, të mos i lëmë pas dore, të ulemi përherë me ta, të marrim e të japim, të dialogojmë e të kemi përherë në vëmendje fjalën e urtë të Hz. Aliut, që thoshte: "Edukoni fëmijët tuaj me një mënyrë ndryshe nga ç'jeni edukuar, sepse ata janë krijuar në një kohë, ndryshe nga koha juaj". Këtu hyn edhe rinia. Sidomos rinia!

Këshilla ime është që mos ta humbin asnjëherë shpresën në mëshirën dhe bekimet e All-llahut, i Cili është përherë me ata që e duan dhe rrugëtojnë drejt dashnisë së Tij, duke mos u frikësuar nga hendeqet e shejtanit dhe vesveset e tij, si: frika për pasurinë, jetesën, kushtet ekonomike, kushtet sociale, ndërtimin e familjes, trashëgimin e jetës, etj.

Besimtari nuk ka frikë në jetë. Frika është e pakuptueshme, kur zemra është e ndërtuar me besim dhe e rrethuar me dashninë e Zotit. Aty nuk ka frikë për asgjë dhe prej asgjëje! Sepse çdo gjë është në dorën e Zotit, i Cili na ka nxitur të punojmë shumë, të mos bëhemi dembelë, të lodhemi shumë e të flemë pak, të shfrytëzojmë rininë, forcat mendore, shpirtërore e fizike, shëndetin e kohën e lirë për të arritur sa më lart në jetë, të mbështetur në Zotin dhe rrugëzgjdhjet që Ai jep, si mrekulli për ne!

Nuk kanë faj, kur kërkohen shpresë në BE dhe ShBA. Janë vende të zhvilluara, ku vlerësohet njeriu, ku shfrytëzohet koha, ku shpërblehet mundi dhe arritjet, ku fitohet e drejta, ku ka shanse për të gjithë që dinë të respektojnë ligjet, tjetrin, punën dhe ku, njeriu vlerësohet për vlerat e tij.

Këtë e them nga udhëtimet dhe eksperiencat e mia në ShBA dhe në shumë vende të BE, ku hapësirat për të zhvilluar një jetë plot shpresë e dinjitet, janë të dukshme.

Nga këtu, i këshilloj shpesh që kudo që të gjenden, të lenë gjurmë të mira, të jenë shembull, të mos shkelin ligjet e vendeve që i kanë hapur dyert për të zhvilluar jetën, të respektojnë besimet e shoqërisë ku jetojnë, sepse feja është e shenjtë për të gjithë, Kur'ani udhëzon: "Ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time!".

All-llahu e bëftë mirë për vendin tim dhe bashkëkombasit e mi dhe për mbarë njerëzimin, sepse e para dhe e fundit qëndron në fjalën e Hz. Muhammedit (a.s.), që thoshte: "Krijesat janë krejt nevojtarë për All-llahun dhe më i dashuri i tyre tek Ai, është më i dobishmi i tyre për ta!"

(www.foldrejt.com)

VAJZA PALESTINEZE IKBAL EL-ESAD, DY HERË NË REKORDIN GUINNESS

Vajza palestineze Ikbal El-Esad, e cila mban leje-kalimin e shtetit të Libanit për emigrantët palestinezë, hyn dy herë rresht në rekordin Guinness.

Herën e parë, kur u regjistrua si studentja më e vogël në moshën 14 vjeçare, pasi u miratua pranimi i saj në fakultetin e mjekësisë Wail Korneil në Katar.



Ajo u diplomua në bachelor shkencor në Liban, kur ishte në moshën 12 vjeçare, ndërkohë më parë kishte arritur të marrë diplomën e shkollës së mesme kur mosha e saj ishte vetëm 10 vjeç.

Ndërsa, herën e dytë që hyri në rekordin Guinness ka qenë atëherë kur mbaroi fakultetin e mjekësisë dhe doli si mjekja më e vogël në botë, ndërkohë që mosha e saj ishte vetëm 20 vjeçe.

Para një viti arriti të marrë miratimin për t'u pranuar në një nga spitalet më të famshme amerikane dhe botërore, për leje qëndrim dhe specializim me një përjashtim të veçantë, ndryshe nga procedurat e zakonshme, pasi bordi drejtues i këtij spitali vuri re talentin dhe zgjuarsinë e saj (që do të thotë, nuk ishte me anë të ndonjë ndërmjetësimi). Duke anashkaluar kushtin e asaj të moshës për të qenë pjesë e stafit, ngase minimumi i moshës për punonjësit e spitalit ishte duke filluar nga mosha 21 vjeç.

Është e habitshme se, Ikbal El-Esad nuk mund të ushtrojë profesionin e saj në Liban për shkak të ligjeve të çuditshme në atë shtet, kështu që, nga dija e saj përfitojnë vendet perëndimore, ndërkohë që vendet arabe e dëbojnë!

(www.musawasyr.org)

Përktheu nga arabishtja:

Ervil Kuçi

ÇFARË ËSHTË XHENETI, SI ËSHTË AI?

A janë të përhershëm Xheneti dhe Xhehenemi? Si përshkruhet Xheneti? Si do të jetë ai? Çfarë ka në Xhenet? Cilat janë mirësitë e tij? A do ta shohim Allahun në Xhenet? Si fitohet Xheneti? Çfarë duhet të bëjmë për të hyrë në Xhenet? Kush do të hyjë në Xhenet? Cilat janë ajetet dhe hadithet në lidhje me Xhenetin? Le të lexojmë më poshtë përgjigjet e këtyre pyetjeve shumë domethënëse...

Së pari, duhet të dimë se Xheneti ekziston i krijuar që në krye të herës, si një mirësi dhe begati e madhe e Krijuesit Fuqiptotë dhe si një shprehje e mëshirës dhe mirësisë së tij të pafundme.¹ Në fund të kësaj jete të përkohshme, Xheneti do shfaqet si një vend prehjeje dhe paqeje për çdo kënd që jetën e ka ndërtuar mbi baza të shëndosha të Kuranit dhe Traditës Profetike, i mbushur me bukuri dhe mirësi që mendja njerëzore nuk mund ti perceptojë dot.

A JANË TË PËRHERSHËM XHENETI DHE XHEHENEMI?

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) përmes një hadithi profetik bën me dije se, në Ditën e Gjykimit vdekjes do t'i jepet fund dhe kështu banorët e Xhenetit apo të Xhehenemit do të jenë të përjetshëm:

“Në Ditën e Gjykimit vdekja do marrë formën e një dashi dhe do qëndrojë midis Xhenetit dhe Xhehenemit. Më pas do të pyetet:

O ju banorë të Xhenetit, a e njihni këtë?

Ata do të zgjasin kokën për të shikuar dhe do thonë:

Po, kjo është vdekja!

Më pas do pyetet:

O ju banorë të Xhehenemit, a e njihni këtë?

Edhe ata do të zgjasin kokën për të shikuar dhe do thonë:

Po, kjo është vdekja.

Pas kësaj do jepet urdhër që vdekja (dashi) të theret. (Më pas do u thuhet banorëve të Xhenetit dhe Xhehenemit:)

O ju banorë të Xhenetit! Tanimë

1. Buhari, Bedu'l-Halk, 8.

jeni të përhershëm, vdekje nuk ka! O ju banorë të Xhehenemit! Tanimë jeni të përhershëm, vdekje nuk ka!

Më pas i Dërguari i Allahut lexoi ajetin:

Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.”²

BESIMTARI QË DO VDESEË NGA GËZIMI

Kur të merret lajmi i përjetësisë do ketë nga ata që do vdesin nga gëzimi ashtu sikurse do ketë edhe nga ata që vdesin nga pikëllimi.³ Në lidhje me këtë të vërtetë i Dërguari i Allahut bën me dije se:

“...Dashi do shtrihet dhe do theret. Nëse Krijuesi Fuqiptotë nuk do kishte vendosur që banorët e Xhenetit të jetonin, ato me siguri do të vdisnin nga gëzimi. Po ashtu nëse Krijuesi Fuqiptotë nuk do kishte vendosur që banorët e Xhehenemit të ishin të përjetshëm, ata do vdisnin nga pikëllimi dhe frika.” (Tirmidhi, Tefsir, 19/3156)

“Nëse dikush do vdiste nga gëzimi, ky do ishte një banor i Xhenetit. Po ashtu nëse do duhej që dikush të vdiste nga pikëllimi ky do ishte një banor i Xhehenemit.” (Tirmidhi, Xhenet, 20/2558)

Ky gëzim dhe ky pikëllim kaq i thellë buron nga fakti që Xheneti dhe Xhehenemi do jenë të përhershëm. A ka se si të jetë e njëjtë gjendja e atij që i premtohet Xheneti me gjendjen

2. Merjem, 39.

3. Buhari, Rikak, 51; Muslim, Xhenet, 40, 43; Tirmidhi, Zuhd, 39, Xhenet, 20, Tefsir, 19; Ibn Maxhe, Zuhd, 38; Ahmed, II, 118, 121, 261; III, 9.

e atij që lajmërohet me Xhehenem? I pari është larg çdo brenge, merak apo shqetësimi sado të vogël, i zhytur në paqen e pafundme të prehjes hyjnore, ndërsa i dyti është i pashpresë, larg çdo mundësie faljeje dhe mëshire nga i vetmi burim i prehjes!

SI FITOHET XHENETI?

Xheneti është një mirësi dhe begati e Krijuesit Fuqiptotë. Në lidhje me këtë i Dërguari i Allahu është shprehur se:

“Askush nuk do hyjë në Xhenet në sajë të punëve dhe veprave të tij.

Sahabët pyetën me habi:

Edhe ti, o i Dërguar i Allahut?

Pejgamberi a.s. u përgjigj:

Po, edhe unë!nëse nuk do më kaplonte mëshira dhe falja e Krijuesit Fuqiptotë as unë nuk do mund të hyja në Xhenet. Punët e mia nuk do mjaftonin!” (Buhari, Rikak, 18; Muslim, Munafikun, 71-72)⁴

Nga kjo kuptojmë se përveç adhurimeve, përkushtimit, punëve të mira dhe të shërbyerit ndaj fesë, neve si krijesa të Zotit na takon t'i mbështetemi faljes dhe mëshirës së Tij të pakufishme duke treguar kësisoj edhe një ndjeshmëri dhe edukatë të lartë gjatë adhurimeve tona.

Nga ana tjetër, shkalla e lartë e besimit dhe sinqeritetit në punë janë disa kritere të qenësishme për të fituar kënaqësinë e Krijuesit në mënyrë që të mbërrijmë në nivelet më të larta të Xhenetit.

Ata të cilët e kalojnë jetën e kësaj bote të zhytur në arrogancë, mendjemadhësi dhe mos kokëçarje duke pandehur se nuk

4. Ibn Maxhe, Zuhd, 20; Darimi, Rikak, 24.

do japin llogari, në Ditën e Gjykimit do jenë të përhumbur në frikën e thellë që do i mbërthejë pa prituri.

Kështu në ajetin fisnik thuhet:

“...Ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.” (Naziat, 40-41)

“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!” (Rahman, 46)

“Më parë, Ne kemi pasur frikë në familjet tona (nga gjykimi i Allahut), por, Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese (e Zjarrit). Ne qysh më parë i jemi falur Atij. Ai është vërtet Bamirës dhe Mëshirëplotë”. (Tur, 26-28)

Kurani Famëlartë na mëson se banorët e Xhenetit nuk do të përjetojnë asnjë moment mërzie dhe lodhjeje:

“Pastaj do të thonë: “Lavdi Allahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtetë, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues. Është Ai që me mirësinë e Tij na ka pranuar në shtëpinë e banimit të përhershëm, në të cilën nuk do të lodhemi e nuk do të rraskapitemi.” (Fatir, 34-35)

I Dërguari i Allahut në një hadith profetik është shprehur se:

“Zemra e një grupi njerëzish që do hyjnë në Xhenet i ngjan zemrës së zogut (e mbështetur plotësisht tek Allahu.)” (Muslim, Xhenet, 27)

Me pak fjalë, mund të themi se Xheneti është vendstrehimi i njerëzve të cilët druhen nga humbja e kënaqësisë së Allahut, tregohen të kujdesshëm të mos kapërcejnë kufijtë e vendosura nga Krijuesi Fuqiptotë dhe ruhen nga lëndimi i zemrave, duke shfaqur kështu një ndjeshmëri të lartë si krijesa të Zotit.

SI PËRSHKRUHET XHENETI?

Krijuesi Fuqiptotë në Kuranin Famëlartë bën me dije se gjerësia e Xhenetit është sa qiejt e toka:

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit...” (Al-i Imran, 133)⁵

Ndërsa i Dërguari i Allahut është shprehur se:

“Xheneti ka njëqind shkallë. Hapësira midis tyre është njëqind vite.” (Tirmidhi, Xhenet, 4/2529)

“Banorët e Xhenetit që ndodhen më poshtë do i shohin ata që ndodhen

5. Hadid, 21.

më lart, siç i shihni ju yjet në qiellin tuaj. Ebu Bekri dhe Omeri janë prej të lartësuarve madje edhe më shumë.” (Tirmidhi, Menakib, 14/3658; Ibn Maxhe, Mukaddime, 11; Ahmed, III, 26, 98)⁶

Sipas një tjetër transmetimi ka thënë:

“Pa dyshim, banorët e Xhenetit do i shohin ata që ndodhen më lart tyre sikurse shohin një yll të madh e të ndritshëm duke perënduar në agimin e mëngjesit.”

Kur e dëgjuan këtë sahabet thanë:

O i Dërguar i Allahut, medoemos aty është vendi i Pejgamberëve, nuk mund të hyjë askush tjetër pos tyre!

I Dërguari i Allahut u përgjigj:

Përkundrazi, bashkë me to do hyjnë edhe të tjerë. Dhe më pas i rënditi cilësitë e tyre:

Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, aty është vendstrehimi i të gjithë atyre që besuan pejgamberët dhe gjithçka sollën ata. (Buhari, Bedu'l-Halk 8, Rikak, 51; Muslim, Xhenet, 11)

Në lidhje me bukuritë magjepsëse të Xhenetit në disa hadithe profetike transmetohet se:

“Ndërtesat e Xhenetit janë me tulla prej ari dhe argjendi. Ata janë të ndërtuara me material që ka aromë misku dhe me gurë prej perlave dhe jakutëve. Ndërsa toka mbi të cilën janë ndërtuar, është prej shafrani. Të gjitha trungjet e pemëve të Xhenetit janë prej ari.⁷ Madje “Në Xhenet ekziston një pemë gjerësia e së cilës është aq e madhe saqë nuk do mjaftonin 100 vite për një kalorës që ta përshkojë atë nga njëri cep në tjetrin.”⁸

Enët e ushqimit të Xhenetit dhe çdo gjë brenda tyre do jenë prej argjendi. Ka prej sosh që do jenë edhe prej ari.⁹

BEGATITË E XHENETIT

Kurani Famëlartë përshkruan në shumë ajete bukuritë dhe begatitë e Xhenetit. Në disa prej tyre thuhet se:

Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre t'u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë: “Këtë e kemi ngrënë edhe përpara”. Por atyre do t'u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të Tokës. Në Xhenet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë. (Bekare, 25)

6. Buhari, Rikak, 51; Muslim, Xhenet, 10.

7. Tirmidhi, Xhenet, 1/2525.

8. Buhari, Rikak, 51, Bedu'l-Halk 8, Tefsir 56/1; Muslim, Xhenet, 6-8; Tirmidhi, Xhenet, 1/2524.

9. Tirmidhi, Xhenet, 2/2528.

Vërtet, punëmirët do të jenë në kopshtet e Xhenetit pranë burimeve. Atyre do t'u thuhet: “Hyni atje me paqe dhe siguri”! Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane. Aty nuk do t'i mendojë lodhja e prej aty kurrë nuk do të dëbohen. (Hixhr, 45-48)

Pikërisht atyre u përket Xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur! (Kehf, 31)

Banorët e Xhenetit do harrojnë ndjenjën e frikës dhe pikëllimit dhe do gostisen me bukuritë e pa imagjinueshme të Xhenetit. Në ajetin fisnik thuhet:

(Allahu do t'u thotë): “O robërit e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni. Ju që keni besuar shpalljet Tona dhe keni qenë myslimanë, hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja, ku do t'ju shërbehet me pjata dhe gota prej ari. Aty do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë. Ja, ky është Xheneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë. Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani.” (Zuhruf, 68-73)

Por Allahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim dhe, për durimin e tyre, Ai do t'i shpërblejë me Xhenet dhe petka të mëndafsha. Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë. Hija e pemëve të tij (Xhenetit) është afër mbi kokat e tyre, ndërsa frutat e tyre do t'i kenë afër sa t'i arrijnë me dorë. Aty do t'u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali, kupa të tejdukshme argjendi, madhësinë e të cilave (do ta zgjedhin) sipas dëshirës. Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil, prej një burimi të quajtur Selsebil. Atyre do t'u shërbejnë djem përherë të rinj, që, kur i shikon, të duken si margaritarë të shpërndarë. Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe. Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjendit. Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër. (Insan, 11-21)

Përktheu dhe përshtati:

Elona SYTARI

(Osman Nuri Topbaş ef., Ebediyet Yolculuğu)

"Aty do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë. Ja, ky është Xheneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë. Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani." - (Kur'ani, Ez-Zuhruf: 68-73)

"BEJTUL-HIKME", OSE SHTËPIA E URTËSISË NË BAGDAD

Në epokën abasite, bota islame tashmë ishte pajisur me diturinë e ndritur fetare. Në këtë kohë, kultura islame në popull ishte konsoliduar dhe kishte arritur pjekurinë e saj. Fusha të ndryshme të shkencave fetare, siç janë shkencat e Kur'anit, të Tefsirit (Komentimit të Kuranit), të Hadithit, dhe të gjitha ato shkenca që njihen si Shkencat e Transmetuara, të cilat përcillen sa më me besnikëri dhe pastërti nga burimi fillestar, kishin arritur një zhvillim mjaft të madh.

Gjithashtu, në këtë epokë, bota islame kishte arritur të shtrihej në një territor të gjerë dhe ishte bërë një shtet shumë i fortë, e si rrjedhojë, ekonomia e tyre aso kohe ishte mjaft e mirë.

Të frymëzuar nga ajete të shumta të Kur'anit të ndritur dhe nga Hadithe të shumta të Profetit Muhammed (a.s) që nxisin në përfitim të dijes, duke u ndihmuar edhe nga kushtet e mira ekonomike në atë periudhë, kalifi i muslimanëve ndërmoi një nismë për themelimin e një qendre të madhe shkencore, ku të përfshiheshin të gjitha fushat e shkencës, si ato fetare, ashtu edhe shkencat e tjera si matematika, fizika, mjekësia, filozofia, astronomia, etj.

Zoti i Lartëmadhërishtëm thotë në Kur'an: "Lexo në emër të Zotit tënd, i Cili krijoi! E krijoi njeriun nga një pikë gjaku e ngjizur. Lexo, e Zoti yt është më bujari... Ai që mësoi (të shkruhet) me penë...I mësoi njeriut atë çfarë nuk e dinte." - (Kur'ani, El-Alak: 1-5)

"Allahu dëshmon se s'ka zot tjetër përveç Tij, e këtë e dëshmojnë edhe engjëjt, edhe njerëzit që kanë dituri... [dhe dëshmojnë se Ai është] që mban drejtësi. S'ka zot tjetër përveç Tij! Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti." - (Kur'ani, Ali Imran: 18)

"Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Vërtetë, përkujtohen ata që kanë mend." - (Kur'ani, Ez-Zumer: 9)


"Dhe thuaj: Zoti im! Më pasuro me dituri!" - (Kur'ani, Ta-Ha: 114)

Ndërsa Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të,

thoshte:

"Kërkimi i diturisë është detyrë për secilin musliman." - (Ibn Maxheh)

"Ai që ndjek një rrugë në kërkim të diturisë, Allahu do t'ia bëjë të lehtë rrugën e Xhenetit. Engjëjt ulin krahët mbi kërkuesin e dijes, duke qenë të kënaqur me atë që ai bën. Banorët e qiejve dhe të tokës, dhe madje edhe peshqit në thellësinë e oqeanëve, kërkojnë falje për kërkuesin e dijes. Superioriteti i njeriut të ditur mbi adhuresin e thjeshtë, është si superioriteti i hënës së plotë ndaj pjesës tjetër të yjeve (d.m.th, në shkëlqim). Dijetarët janë trashëgimtarët e Profetëve. Profetët, nuk kanë trashëguar dinar as derhem (flori as argjend) por kanë trashëguar dituri, dhe kush e merr atë, në fakt ka fituar një pjesë të bollshme." - (Tirmidhiu)



"Kur njeriu vdes, puna e tij ndërpritet, përveç tri gjërave: përveç bamirësisë që vazhdon, diturisë që ai lë pas dhe nga e cila përfitojnë njerëzit, ose kur lë një fëmijë të mirë që lutet për të." - (Muslimi)

Këto dhe shumë ajete kur'anore të tjera dhe hadithe Profetike që flasin për vlerën e diturisë, i shtynë muslimanët në kërkimin e mëtejshëm të dijes.

Siç e kemi përmendur në shkrimin e kaluar, bërthamën e një qendre diturie në Bagdad, në fillim e pati vënë kalifi musliman Harun Reshidi, qendër të cilën e quajti "Depoja e Urtësisë", por ky institucion e arriti kulmin e veprimtarisë së tij shkencore vetëm në ditët e të birit, kalifit abasit "El-Me'mun" (786 - 833 e.j.).

Kalifi El-Me'mun karakterizohej për mendjen e tij të ndritur, për mendimin e hapur, si dhe për kulturën e tij të gjerë. Prandaj, pothuajse pa zënë mirë vend si kalif i abasitëve në Bagdad, ai solli një ndryshim të madh në "strategjinë"

kulturore të shtetit abasid. Nëpërmjet formimit dhe studimeve të tij nga njëra anë, si dhe nëpërmjet marrëdhënieve të tij të ngushta me njerëz të shkencës dhe letërsisë (si me arabët muslimanë, ashtu edhe me arabët e krishterë nestorianë, me persianët, indianët dhe sabi'inët) nga ana tjetër, ai kuptoi se ndërtimi dhe lulëzimi i civilizimit arabo-islam varej nga bashkëpunimi dhe dialogu midis tyre si muslimanë, me qytetërimet e tjera. Ai e vlerësonte përfitim nga thesaret e dijes së qytetërimeve të tjera, sepse gjetjet shkencore të tyre i shihte si pronë e të gjithë njerëzimit, pavarësisht nga besimet, racat dhe ngjyrat e atyre dijetarëve.

Nisur nga kjo "doktrinë shkencore", El Me'mun i hapi dyert e përkthimit të gjerë në arabisht. Në fakt, përkthimi nga qytetërimet e tjera në arabisht, pati

filluar që në periudhën emevite, atëherë kur disa libra të kimisë u përkthyen nga greqishtja në arabisht, me kërkesë të princit emevit, Halid ibn Jezid. Por, këto dhe përkthime të tjera ishin të gjitha nisma individuale spontane, që kishin të bënin me fusha shkencore të caktuara, ndërsa në epokën e kalifit El-Me'mun, përkthimi u bë

një politikë ose të themi "një strategji e përgjithshme" e shtetit abasit. Ky aktivitet tanimë nuk lidhej me dëshirën e këtij kalifi apo të atij princi, siç nuk lidhej vetëm me një fushë të shkencës apo me një tjetër, por filloi të përfshinte pjesën më të madhe të shkencave dhe njohurive që lulëzuan në qytetërimet antike.

Nën dritën e vizionit të tij, El-Me'munit pa se "Depoja e Urtësisë" e themeluar nga i ati, nuk mund të promovonte projektin e madh kulturor që ky po synonte të bënte, prandaj, ai e shndërroi këtë nismë në një institucion shkencor, të njohur si "Bejtul Hikmeh - Shtëpia e Urtësisë". Filluan të mblidheshin libra e dorëshkrime që përmbanin trashëgiminë e qytetërimeve të lashta, dhe të përktheheshin në gjuhën arabe.

Në fakt, misioni i këtij institucioni nuk ishte thjeshtë mbledhja e librave, përkthimi dhe shumimi i kopjeve të tyre, por më shumë ishte për qëllim përqafimi i idesë së dialogut midis qytetërimeve dhe shkëmbimi mes tyre

i njohurive shkencore, letrare dhe i mjeshtërive të ndryshme. Vërtetë, kjo qendër u kthye në një "shesh" të dialogut mes qytetërimeve të lindjes dhe të perëndimit, sidomos mes qytetërimit arab Islam dhe qytetërimit grek, persian, asirian dhe indian.


Dialogu midis qytetërimit arab-islamit dhe qytetërimeve të huaja të lashta, sidomos atij grek, luajti një rol të rëndësishëm për kalimin e dijetarëve arabë dhe muslimanë, në fazën e gjenialitetit dhe të krijimtarisë. Studiuesit arabë dhe muslimanë, përveç se i përkthyen dhe i studiuin ato shkenca, i zhvilluan edhe më tej ato. Ata dëshmuar jo vetëm aftësinë e tyre për ta përvetësuar atë trashëgiminë të lashtë shkencore, por edhe për ta kritikuar dhe tejkaluar atë nga njëra anë, dhe për ta përdorur atë në plotësimin e nevojave intelektuale dhe materiale të shoqërisë së tyre të asaj kohe, nga ana tjetër.

MBLEDHJA E DORËSHKRIMEVE

Kalifi El-Me'mun arriti t'i posedonte dorëshkrimet e trashëgimisë së qytetërimeve të huaja antike, si nga brenda botës arabe dhe islame, ashtu edhe nga jashtë saj. Përsa u përket dorëshkrimeve greke, ato i mori nga Qiproja dhe nga Kostandinopoja. Kalifi musliman i zgjodhi vetë personalisht njerëzit e përshtatshëm, të cilët do t'i dërgonte tek sundimtarët e atyre vendeve, për t'ua kërkuar në emër të tij dorëshkrimet e lashta. Në Shtëpinë e Urtësisë mbërritën sasi të mëdha dorëshkrimesh greke të cilat vinin gjithashtu edhe nga manastiret dhe kishat e vendeve të Shamit dhe Mesopotamisë, dhe kjo u arrit përmes studiuesve të krishterë arabë.

Pasi këto koleksione të trashëgimisë greke mbërritën në Shtëpinë e Urtësisë dhe u klasifikuan dhe u rregulluan sipas procesit të duhur, El Me'muni hapi dyert që aty të punonin ekspertët e fushave të përkthimit, të shkencës, mjekësisë dhe të letërsisë.

Kriteri kryesor i punës në këtë institucion ishte kompetenca shkencore. Shkencëtarët më me fat për të qenë pjesë e grupit të punës aty ishin ata që zotëronin një gjuhë të huaj ose më shumë, dhe ata të cilët ishin të shquar në ndonjë nga fushat shkencore, dhe që dalloheshin për saktësinë dhe



integritetin e tyre shkencor.

Shteti abasit vuri shumën e mëdha parash në dispozicion të Shtëpisë së Urtësisë dhe të aktiviteteve të saj shkencore. Për shembull, shumën e mëdha parash paguheshin për blerjen dhe transferimin e dorëshkrimeve, shumën e tjera të mëdha jepeshin për përkthyesit, shkencëtarët, administratorët, për kopjimin, monitorimin, mirëmbajtjen, etj. Burimet konfirmojnë se disa përkthyesve, si Hunejn ibn Is'hak, si shpërblim për përkthimin që bënin, El Me'muni u jepte aq flori sa pesha e librit që përkthehte.

KËRKIMET SHKENCORE NË SHTËPINË E URTËSISË

Dijetarët muslimanë treguan një interes të fortë për të asimiluar njohuritë shkencore të qytetërimeve të lashta. Shumë vepra klasike të antikitetit, nga qytetërimet greke, persiane, indiane, kineze, egjiptiane dhe fenikase, të cilat përndryshe mund të ishin humbur, u përkthyen në arabisht dhe persisht, e më vonë u përkthyen edhe në turqisht, hebraisht dhe latinisht.

Përveç përkthimeve, tashmë filloi të vihej në lëvizje dhe të nxitej edhe kërkimi shkencor dhe të shkruarit, veçanërisht pasi ajo bibliotekë e madhe në Shtëpinë e Urtësisë, i ndihmonte mjaft shkencëtarët për t'i realizuar projektet e tyre kërkimore. Disa studime tregojnë se numri i librave, të shkruar apo të përkthyer në Shtëpinë e Urtësisë, arrinte në rreth një milion libra.

ROLI I SHTËPISË SË URTËSISË NË RUAJTJEN E TRASHËGIMISË SË QYTETËRIMEVE TË LASHTA

Trashëgimia kulturore e qytetërimeve të lashta përfitoi shumë nga puna e bërë në Shtëpinë e Urtësisë. Me rëndësi ishte veçanërisht shërbimi i madh që ajo i solli trashëgimisë antike Greke nga asgjësimi, mbyllja dhe nënvlerësimi, gjëra të cilat i vuajti në perëndimin evropian edhe

në botën bizantine. Është një gjë që dihet se Kisha në Perëndim e pati luftuar brutalisht trashëgiminë e lashtë të kulturës Greke. Ajo e shikonte këtë trashëgimi si të dëmshme për besimin e krishterë, ngaqë ishte e lidhur me paganizmin. Kisha i ndaloi të krishterët të shikonin në ato dorëshkrime, duke i konsideruar ato si vepra të djallit. Për këtë arsye, shkrimet e shumicës së filozofëve

dhe shkrimtarëve Grekë u lanë pas dore dhe u përçmuan. Ky qëndrim armiqësor ndaj trashëgimisë kulturore greke nga ana e kishës pati vazhduar për shekuj me radhë.

Shtëpia e Urtësisë e themeluar në Bagdad të Irakut, luajti një rol të madh në ruajtjen e kësaj trashëgimie.

PËRFITIMET QË PATI NJERËZIMI NGA SHTËPIA E URTËSISË

Shtëpia e Urtësisë, ishte si një "fabrikë" ku bëhej mbledhja, përkthimi, asimilimi i njohurive dhe i urtësive antike të botës së lashtë, ruajtja e tyre, dhe përmirësimi i mëtejshëm i kësaj trashëgimie. Ky institucion luajti një rol të rëndësishëm në historinë e njerëzimit në tërësi, sepse ishte ura nëpërmjet të cilës, trashëgimia kulturore dhe shkencore e qytetërimeve të lashta, përfshi edhe ajo Islame, u transmetua në Perëndim.

Shtëpia e Urtësisë mund të konsiderohet si "pikënisja" e shkencës moderne. Falë "Shtëpisë së Urtësisë" në Bagdad, si dhe falë shkollave dhe librave të ngjashme të krijuara më vonë sipas modelit të saj, u ruajt vazhdimësia e civilizimit njerëzor, pas rënies së civilizimeve të lashta greke, romake, persiane, etj.

Përsa i përket botës islame në veçanti, aktiviteti i bërë në Shtëpinë e Urtësisë në Bagdad të Irakut, vuri bazat për një epokë të re e të ndritur, e cila do të vinte menjëherë më pas, dhe që do të njihet si "Epoka e Artë e Islamit", epokë për të cilën, me lejen e Zotit, do të flasim në shkrimin që vijon.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm...)

Përgatiti:

Msc. **Arta Ujkaj**, teologe

1. <https://www.islamstory.com/ar>
2. <https://www.degruyter.com>



Dr. Mustafa Mahmud

Miku im, me shumë zhurmë, duke menduar se ai këtë herë më ka kapur për fyti dhe se unë nuk kam rrugëdalje tjetër, më thotë: Ju thoni, se Allahu, në mbretërinë e Tij, çdo gjë e ka përcaktuar (me kada dhe kader); dhe se Allahu na i ka caktuar veprat tona, e nëse kjo është gjendja ime dhe se të gjitha veprat e mia janë të përcaktuara tek Ai, atëherë përse më merr në llogari?

Mos më thuaj siç e ke zakon, unë kam liri zgjedhjeje, sepse nuk ka gënjeshtër më të madhe se sa kjo gënjeshtër. Më lër të të pyes:

A kam qenë i lirë të zgjedhë lindjen time, gjininë, gjatësinë, gjerësinë, ngjyrën dhe atdheun tim?

A, me zgjedhjen time dielli lind dhe hëna perëndon?

A, me zgjedhjen time bie mbi mua kaderi (përcaktimi), ku më befason vdekja, bie në tragjedi dhe nuk kam alternativë tjetër, vetëm se të bëjë krim.

Përse Allahu më detyron për një veprim, pastaj më merr në llogari për të?

Nëse thua, se ti je i lirë dhe se ti ke vullnetin tënd pranë vullnetit të Allahut, a nuk po i bë shirk me këtë fjalë dhe pranon shumësinë e vullneteve?

Pastaj, çfarë thua për ambientin dhe rrethanat, dhe për gjërat e paevitueshme, të cilat i thonë materialistët dhe historianët?

Miku im i lëshoi këto plumba, pastaj u mënjana duke marr frymë lirisht e me qetësi, duke menduar se unë vdiqa dhe mbarova dhe përpara meje, nuk kisha mundësi tjetër, veçse të sillja qefinin.

Me qetësi i thashë: Ti re në disa gabime, sepse veprat tua janë të njohura për Allahun në Librin e Tij, por ato nuk janë të përcaktuara me imponin kundër vullnetit tënd. Ato

NËSE ALLAHU M'I KA PËRCAKTUAR VEPRAT E MIA, ATËHERË PËRSE MË MERR NË LLOGARI?

janë të përcaktuara, vetëm në dijen e Tij, ashtu siç ti parashikon (përcakton), se djali yt do të mund të bëjë imoralitet, pastaj ai me të vërtetë bën imoralitet, a ti e ke detyruar atë? Apo, kjo ka qenë e njohur (përcaktuar) në dije dhe dija jote ia ka qëlluar?

Ndërsa, fjala jote për lirinë e zgjedhjes, se ajo është një gënjeshtër dhe argumentimi yt për këtë, se ty nuk të kanë lënë të zgjedhësh lindjen tënde, gjininë, gjatësinë, ngjyrën e as atdheun tënd dhe se nuk mund ta lëvizësh diellin nga vendi i tij, ky është një gabim tjetër.

Kësaj here, shkaku i gabimit tënd është, se ti e përfytyron lirinë në një mënyrë tjetër, të cilën ne besimtarët e përfytyrojmë.

Ti flet për lirinë absolute dhe thua: A kam pasur mundësi ta krijoj veten time të bardhë, të zi, të gjatë, të shkurtër.. a kam mundësi ta lëvizë diellin nga vendi i tij apo ta ndaloj rrotullimin e tij.. ku është liria ime?

Ne të themi: Ti pyet për lirinë absolute, lirinë e të vepruarit në univers dhe kjo lirinë është pronë vetëm e Allahut dhe askujt tjetër.

Edhe ne gjithashtu nuk themi për këtë liri: “Dhe, Zoti yt krijon çfarë të dëshirojë dhe zgjedhë, ata nuk e zotërojnë këtë liri”. – (Kur’ani, El-Kasas: 68. Askush nuk ka liri në çështjen e krijimit, sepse Allahu është Ai, i Cili krijon çfarë të dëshirojë dhe zgjedhë.

Allahu nuk ka për të të marrë në llogari për shkurtësinë, apo gjatësinë tënde; e as që nuk do të të ndëshkojë, sepse ti nuk e k ndalë diellin të rrotullohet, por fusha e logaridhënies është fusha e obligueshmërisë. Ti në këtë fushë je i lirë dhe këto janë kufijtë për të cilët po flasim.

Ti je i lirë të frenosh epshet tuaj, të zotërosh zemërimin, t’i rezistosh vetes, t’i ndalosh qëllimet tuaj të këqija dhe t’i nxitësh dëshirat tua të mira.

Ti mundesh të sakrifkohesh me pasurinë dhe veten tënde.

Ti mundesh të thuash të vërtetën dhe të gënjesht.

Ti mundesh t’i ndalosh duar tua nga pasuria haram.

Ti mundesh ta ndalosh shikimin tënd nga lakuriqësia e të tjerëve.

Dhe, mundesh ta ndalosh gjuhën tënde të shash, të përgojosh dhe mbartësh fjalë për të tjerët.

Në këtë fushë ne jemi të lirë dhe në këtë fushë ne merremi në pyetje dhe japim llogari.

Liria, rreth të cilët sillet hulumtimi, është liria relative dhe jo liria absolute, liria e njeriut në fushën e obligueshmërisë. Kjo liri është e vërtetë dhe argumenti ynë për të është ndjenja jonë e natyrshme për të, brenda nesh, ku ne ndjejmë për përgjegjësi dhe pendesë kur gabojmë dhe qetësi e prehje për

Allahu e ka bërë zemrën dhe nijetin nyjën kyçe të dispozitave. Besimtari, i cili shqipton me gojë ndonjë fjalë blasfemie (mohon besimin) nën presionin e kërcënimeve dhe torturave, nuk merret në llogari për këtë gjë, për sa kohë që zemra e tij nga brenda është e bindur me besim. Allahu e ka përjashtuar nga llogaria me fjalën e Tij: “Përveç atij që është imponuar dhe zemra e tij është e bindur me besim”

veprën e mirë. Ne ndjejmë në çdo moment, se ne zgjedhim dhe peshojmë (vlerësojmë) supozimet e ndryshme. Madje, puna e parë e mendjes sonë është vlerësimi dhe zgjedhja mes të ndryshmeve.

Ne dallojmë në mënyrë të qartë dhe përcaktojmë në mënyrë të prerë; dora jonë, ndërkohë që dridhemi nga temperatura dhe dora jonë që shkruan letër. Themi: Lëvizja e parë është lëvizje e imponuar, ndërsa lëvizja e dytë është lëvizje e lirë dhe zgjedhëse. Sikur

të ishim të imponuar në të dy rastet, atëherë nuk do të kishim pasur mundësi të bënim dallimin.

Këtë liri e vërteton, ajo pamundësia që ndjejmë në imponimin e zemrës për diçka që nuk është e kënaqur nën peshën e çfarëdolloj presioni. Ti mundesh ta detyrosh një femër, me kërcënim dhe dhunë, që ajo të heq rrobat e saj, por ti nuk mundesh me asnjë lloj presioni apo kërcënim ta bësh atë të të dojë me zemër. Kuptimi i kësaj është, se Allahu i liruar zemrat tona prej çdo lloj imponimi dhe detyrimi dhe se Ai i ka krijuar ato të lira.

Për këtë arsye, Allahu e ka bërë zemrën dhe nijetin nyjën kyçe të dispozitave. Besimtari, i cili shqipton me gojë ndonjë fjalë blasfemie (mohimi të besimit) nën presionin e kërcënimeve dhe torturave, nuk merret në llogari për këtë gjë, për sa kohë që zemra e tij nga brenda është e bindur me besim. Allahu e ka përjashtuar nga llogaria me fjalën e Tij: “Përveç atij që është imponuar dhe zemra e tij është e bindur me besim”. – (Kur’ani, En-Nahl: 106)

Ana tjetër e gabimit (ngatërimit) në këtë çështje është, se disa njerëz e kuptojnë lirinë e njeriut, sikur ajo është sipërore ndaj vullnetit dhe është i pavarur në këtë gjë, e me këtë ai akuzon ata që thonë për lirinë, se ata i kanë shoqëruar Allahut dhe i kanë bërë Atij ortakë, që urdhërojnë si urdhri i Tij, sundojnë si sundimi i Tij dhe, kjo është ajo që ke kuptuar edhe ti gjithashtu, e the për shumësinë e vullneteve. Ky është kuptimi i gabuar, sepse liria njerëzore nuk mund të jetë sipërore ndaj Vullnetit Hyjnor.

Njeriu me lirinë e tij, mund të bëjë diçka që është nën kundërshtim me kënaqësinë hyjnore, por ai në asnjë mënyrë nuk mund të bëjë ndonjë gjë kundër Vullnetit të Tij.

Allahu na e ka dhënë lirinë që të dalim kundër kënaqësisë së Tij dhe “t’i bëjmë mëkat”, por nuk i ka dhënë askujt liri që të jetë sipërore ndaj Vullnetit të Tij. Kjo është një anë tjetër prej anëve të lirisë relative njerëzore.

Çdo gjë që ndodh prej nesh, ajo është e përfshirë dhe brenda Vullnetit Hyjnor, edhe nëse e kundërshton kënaqësinë hyjnore dhe aspektin fetar.

Vetë liria jonë ka qenë dhunti hyjnore dhe dhuratë për ne nga Krijuesi me zgjedhjen e Tij dhe ne nuk e kemi marrë me pahir dhe as me forcë. Liria jonë ka qenë vetë Vullneti i Tij.

Allahu na drejton (orienton) drejt asaj, që ne kemi zgjedhur me zemrat dhe nijetin tonë. Nuk ka padrejtësi (zullum), nuk ka imponim, nuk ka pahir, e as nuk ka ushtrim force ndaj nesh përkundër natyrës sonë.

Nga këtu rrjedh edhe kuptimi i ajetit: “E ju nuk dëshironi, përveçse të dëshirojë Allahu” – (Kur’ani, El-Insan: 30)

Sepse dëshira (vullneti) jonë është brenda Vullnetit të Tij, dhunti e Tij dhe dhuratë prej bujarisë dhe mirësisë së Tij. Ajo është brenda dëshirës së tij, nuk ka dualizëm dhe as kontradiktë, e as konkurrencë prej nesh të urdhrat të Allahut dhe sundimit të Tij.

Kjo liri këtu, me këtë kuptim nuk e mohon Njësinë (Tevhidin) dhe as që i bën Allahut ortakë, që sundojnë me sundimin e Tij dhe urdhërojnë si urdhrat e Tij. Liria jonë ka qenë vetë urdhri i Tij, Vullneti dhe vendimi i Tij.

Ana e tretë e ngatërresës është, se disa të cilët janë marrë me çështjen e “kadasë”, “kaderit”, “lirisë” dhe “imponimit” e kanë kuptuar “kadanë dhe kaderin” (përcaktimin hyjnor) sikur ai është imponim ndaj njeriut përkundër natyrës dhe vullnetit të tij, e ky është gabim në të cilin ke rënë edhe ti gjithashtu. Allahu ia ka ndaluar Vetes imponimin me ajete të qarta: “Nëse duam, zbrisim ndaj tyre ndonjë ajet (shenjë, apo diçka tjetër) prej qiellit dhe qafat e tyre mbesin të nënshtuara (bindura) ndaj tij”. – (Kur’ani, Esh-Shuara: 4)

Kuptimi është i qartë, se ka qenë krejt e mundur t’i detyrojmë (imponojmë) njerëzit të besojnë dhe ajetet (shenja) të detyrueshme, por Ne nuk e kemi bërë, sepse nuk është në praktikën Tonë imponimi.

“Nuk ka imponim (detyrim) në fe, është sqaruar udhëzimi nga humbja”. – (Kur’ani, El-Bekare: 256)

“Sikur të kishe dashur Zoti yt, patjetër që do të kishin besuar të tërë ata që janë në tokë, të gjithë. A, ti do t’i imponosh (detyrosh) njerëzit, që ata

të jenë besimtarë?” – (Kur’ani, Junus: 99) Nuk është në praktikën e Allahut imponimi.

“Kadaja dhe kaderi” (përcaktimi hyjnor) nuk duhet të kuptohet sikur ai është imponim i njerëzve përkundër natyrës së tyre, madje është e kundërta. Allahu për çdo njeri gjykon mbi bazën e nijetit të tij dhe i dëshiron atij prej vetë llojit të vullnetit dhe dëshirës së tij; nuk ka dualizëm. “Imponimi” i Allahut është vetë thelbi i zgjedhjes së lirë të robit, sepse Allahu çdo njeri e drejton (i jep drejtim) sipas epshit të zemrës së tij dhe sipas nijetit të tij.

“Kush dëshiron shpërblimin e ahiretit, Ne ia shtojmë shpërblimin e tij dhe kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne i japim prej saj”. – (Kur’ani, Esh-Shura: 20)

“Në zemrat e tyre ka sëmundje, e Allahu u shtoi atyre sëmundje”. – (Kur’ani, El-Bekare: 10)

“Dhe ata, të cilët u udhëzuan, atyre u shtoi udhëzim”. – (Kur’ani, Muhammed: 17)

Ai u drejtohet robërve të luftës në Kur’an:

“Nëse Allahu di, se në zemrat tuaja ka mirësi, do t’ju japë më të mirë se sa ajo që është marr prej jush”. – (Kur’ani, El-Enfal: 70)

Allahu vendos dhe përcakton dhe vendimi dhe përcaktimi i Tij rrjedhin sipas nijetit dhe zemrës; nëse është keq, atëherë keq dhe nëse është mirë, atëherë mirë. Kuptimi i kësaj është se nuk ka dualizëm. Detyrimi është vetë zgjedhja e lirë dhe, as që ka dualizëm apo kontradiktë.

Allahu na drejton (orienton) drejt asaj, që ne kemi zgjedhur me zemrat dhe nijetin tonë. Nuk ka padrejtësi (zullum), nuk ka imponim, nuk ka pahir, e as nuk ka ushtrim force ndaj nesh përkundër natyrës sonë.

“E, ndërsa ai që jep dhe është ruajtur (përkushtuar), e beson, Ne do ta drejtojmë drejt të lehtës. Dhe, ndërsa ai që nuk jep dhe tregohet i panevojshëm (për shpërblimin e Zotit), e nuk beson, Ne do ta drejtojmë drejt të vështirës”. – (Kur’ani, El-Lejl: 5)

“Ti nuk gjuaje kur gjuaje, por Allahu gjuante”. – (Kur’ani, El-Enfal: 17)

Këtu takohet gjuajtja e robit dhe gjuajtja e përcaktuara nga Zoti dhe bëhet gjuajtje e vetme. Ky është çelësi i misterit të “kadasë dhe kaderit” (përcaktimit hyjnor). Robi duhet të bëjë

nijet dhe Allahu ia mundëson atë, nëse ka nijetin e mirë, mirë ia mundëson dhe nëse ka nijetin e keq, atëherë keq ia mundëson.

Liria e njeriut nuk është përcaktim i pandryshuar, por ajo është kapacitet relativ, që pranon shtesë.

Njeriu mund ta shtojë lirinë e tij me dituri. Me shpikjen e mjeteve, metodave dhe komunikacionit, njeriu ka mundur ta “palosë” tokën, të thyejë distancat dhe të çajë prangat (kufizimet) e kohës dhe vendit. Me studimin e ligjeve të natyrës, ai arriti ta kontrollojë atë dhe ta nënshtrojë në shërbim të tij. Ai diti se si ta mposht të nxehtit, të ftohtit dhe errësirën, e me këtë dyfishon lirinë e tij në fushën e veprimit.

Dituria ishte mjet në thyerjen e kufizimeve dhe prangave dhe, dhënies së lirisë.

Ndërsa, mjeti i dytë ishte feja. Ndihej prej Allahut dhe të afuarit tek Ai. Marrja prej Tij me Shpallje, inspirim dhe mbështetje. Kjo është mënyra e Profetëve dhe kujtdo, që ecë në rrugën e tyre.

Sulejmani i nështroi xhinët, lëvizi erën dhe u foli shpendëve me ndihmën e Allahut dhe mbështetjen e Tij.

Musai çau detin, Isai ringjalli të vdekurit, eci mbi ujë, shëroi zgjeben dhe verbërimin.

Lexojmë për evliatë e Allahut dhe kerametet e tyre, që u “paloset” toka dhe u zbulohen të fshehtat.

Këto janë shkallë të lirisë, që e kanë fituar me përpjekjet e tyre në adhurim dhe afim tek Allahu dhe dashurinë ndaj tij. Ai u dha prej dijes së Tij të fshehur.

Edhe një herë, kjo është dija.

Por, këtë herë është dija “ledunite” (dija hyjnore e dhuruar).

Për këtë arsye, Ebu Hamid El-Gazali e përmbledh problemin e “zgjedhjes së lirë” dhe “imponimit” me dy fjalë duke thënë: “Njeri është i lirë për atë që di

dhe është i imponuar për atë që nuk di”.

Ai do të thotë, se sa më shumë që shtohet dituria, aq më tepër shtohet fusha e lirisë, pa marrë parasysh se cila dije është, dija objektive (e fituar) apo dija “ledunite” (dija hyjnore e dhuruar).

Mendimtarët materialistë gabojnë shumë kur e parafytyrojnë njeriun skllav të paevitueshme historike dhe shtresore (klasore), duke i bërë atij një hallkë në zinxhirin e hallkave të pazgjidhshme për të, që nuk ka shpëtim prej nënshtërimit të ligjeve ekonomike dhe lëvizjeve shoqërore, sikur ai është fije kashte në rrymën e erës, pa krahë dhe pa vullnet.

Fjalë, të cilën e përsërisin dhe nuk lodhen duke përsëritur, sikur ajo të jetë ligj: “Pashmangshmëria e luftërave të klasave” dhe kjo është fjalë e gabuar në analizën shkencore, sepse nuk ka pashmangshmëri në fushën njerëzore, por më tepër është supozim dhe preferenca. Ky është dallimi mes njeriut dhe mes ingranazheve, mjeteve dhe trupave lëndorë. Mundet të parashikohet (përlllogarit) eklipsi i diellit me minuta dhe sekonda dhe mundet të përlllogaritet lëvizja e tij në të ardhmen me vite të tëra, ndërsa njeriu, askush nuk mund ta dijë, se çfarë mbanë dhe fsheh në nijetin e tij dhe, çfarë do të bëjë nesër ose pasnesër. Nuk mund të dihet kjo gjë, vetëm me tahmin, supozim apo preferencë dhe kjo nëse themi se kemi të dhëna të mjaftueshme për të gjykuar.

Të gjitha parashikimet e Karl Marksit kanë dështuar (kanë qenë gabim), sepse komunizmi nuk filloi (nuk u përhap) në vendet e përparuara, ashtu siç parashikoi, por në vendet e prapambetura. Nuk u rrit përplasja me kapitalizmit dhe komunizmit, madje të dy palët u afuan deri në bashkëjetesë paqësore. Edhe më shumë se kaq, vendet komuniste hapën dyert e tyre për kapitalin amerikan. As që u rritën kontradiktat në shoqëritë kapitaliste

deri të falimentim, siç e kishte parashikuar Karl Marks, madje ndodhi e kundërta, lulëzoi ekonomia kapitaliste dhe ndodhi ndarja dhe përçarja mes palëve të vetë kampit socialist.

Përlllogaritjet e Karl Marksit gabuan të tëra duke treguar me këtë gjë gabimin e pashmangshëm të metodës së tij dhe, pamë konfliktin e kohës, të cilin e lëviz historia e që është konflikt jo klasor mes Kinës dhe Rusisë, e jo konflikt klasor, të cilin Marks e kishte bërë kryetitull të metodës së tij. Të gjitha këto janë dëshmi të dështimit të mendimit materialist në kuptimin e njeriut dhe historisë dhe, rënie në grackë për llogari të së ardhmes. E gjitha kjo erdhi si rezultat i një gabimi esencial, e ai është se mendimi materialist e parafytyron njeriun mizë në rrjetën e pashmangshmërive dhe harroi krejtësisht se njeriu është i lirë dhe liria e tij është realitet.

Ndërsa, për sa i përket fjalës (mendimit) së materialistëve për gjykimin e mjedisit, shoqërisë dhe rrethanave dhe se njeriu nuk jeton i vetëm dhe liria e tij nuk lëviz në boshllëk, ne u themi duke iu përgjigjur kësaj fjale (këtij mendimi): Gjykimi i mjedisit, shoqërisë dhe rrethanave si pengesa të lirisë individuale, e përforcon kuptimin dialektit të kësaj lirie dhe nuk e mohon. Sepse, liria individuale nuk e vërteton veten e saj, përveçse përballë një pengese të cilën e mënjanon.

Nëse njeriu lëviz në boshllëk pa pengesa të çfarëdo lloji, atëherë ai nuk është i lirë sipas kuptimit të domethënies së lirisë, sepse ai nuk do të ketë pengesë që ta parakalojë dhe që ta vërtetojë lirinë e tij përmes saj.

(Marrë nga libri:
DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Çdo lavd dhe falënderim i përket Allahut, i Cili i shpalli robit të Vet (Muhammedit) një Libër të dërrë nga çdo shtrembërim, (një libër) të drejtë, për të paralajmëruar nëpërmjet tij, dënim të ashpër (për jobesimtarët) dhe për t'u dhënë lajmin e mirë besimtarëve, të cilët bëjnë vepra të mira, se për ta do të ketë një shpërblim të bukur (Xheneti), në të cilin do të qëndrojnë përherë.¹

Përpara që të kaloj për të folur për suren Kehf, kam dëshirë që të ndalem dhe të sqaroj dy gjëra të rëndësishme:

E para: Rrëfimet kur'anore kanë 3 veçori kryesore që dallojnë prej rrëfimeve të tjera.

E dyta: Qëllimet që kanë tregimet kur'anore.

Rrëfimet kur'anore nuk janë imagjinata dhe as ilustrime artistike, nuk janë thënë për t'u çlodhur apo për të kaluar kohën, por janë ngjarje reale të jetuara në një periudhë kohore të caktuar të njerëzimit.

Rrëfimet kur'anore kanë 3 veçori kryesore që dallojnë prej rrëfimeve të tjera:

1. Janë rrëfime të vërteta. Allahu (xh. sh) thotë: “Pa dyshim, të gjitha këto janë rrëfime të vërteta”.²

2. Rrëfimet që tregohen në Kuran janë të prezantuara me një stil artistik të rrallë.

3. Prej këtyre rrëfimeve dhe tregimeve merret mësim. Ato kanë qëllime të caktuara shkencore, ideologjike, edukative dhe propaganduese. Allahu i Madhëruar thotë: “Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë”.³

1. Kur'ani, El-Kehf: 1-3.
2. Kur'ani, Ali Imran: 62.
3. Kur'ani, El-Araf: 176.

SUREJA EL-KEHF DHE MËSIMET E SAJ

QËLLIMET E TREGIMEVE KUR'ANORE:

- **Vërtetimi i shpalljes dhe profetësisë së Muhammedit (a.s).** Allahu i Madhëruar thotë: “Këto janë (disa) nga lajmet e fshehta që Ne t'i shpallim ty. Këto nuk i ke ditur as ti, as populli yt para kësaj (shpalljes së Kur'anit). Andaj, duro! Se, vërtet në fund, fitorja është e besimtarëve”.⁴

- **Përforsimi i faktit se burimi i shpalljes është i njëjtë.** Nga objektivat e tregimeve kur'anore është tërheqja e vëmendjes, se feja me të cilën Allahu ka dërguar profetët, është e njëjtë dhe në origjin të gjitha legjislacionet qiellore nuk kanë kundërtënie. Kjo vihet qartësisht në pah në shumë rrëfime kur'anore.

Në suren Enbija, pasi përmenden tregimet e disa profetëve, Allahu i Madhëruar thotë: “Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe, kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua”.⁵

- **Përfitimimi dhe marrja mësim nga tregimet kur'anore.** Nëpërmjet tregimeve, Kur'ani e merr njeriun dhe e çon larg në kohë, me qëllim që ai të shikojë se si ka qenë gjendja e popujve të mëparshëm. Kur'ani jep një panoramë të qartë të ngjarjeve, shkaqeve të tyre dhe përfundimin e tyre, qoftë ky përfundim i mirë apo i keq. Kur'ani e ndërgjegjëson mendjen, duke i kujtuar përfundimin e çdokujt që ka pranuar të vërtetën, apo që e ka refuzuar atë. Rrëfimi kur'anor e rrëmben lexuesin, i cili ndikohet edhe më shumë kur shikon përputhje mes tij dhe individit të përmendur në rrëfimin kur'anor. Kështu lexuesi e kupton rezultatin që ka pasimi apo refuzimi i të vërtetës, shpërblimi apo ndëshkimi.⁶

- **Demaskimi i intrigave dhe mashtrimeve të ithtarëve të librit, të cilët në shumicën e rasteve nuk i tregonin rrëfimet profetike.** Allahu i Madhëruar thotë: “Të gjitha ushqimet kanë qenë të lejuara për bijtë e Izraelit, përveç asaj që Izraeli (Jakubi a.s) ia ndaloi vetes para shpalljes së Teuratit. Thuaj (o Muhammed): “Silleni Teuratin dhe lexojeni atë, nëse thoni të

vërtetën”.⁷

- **Forcimi i zemrës së Profetit (a.s) në fushën e thirrjes islame dhe mbjellja e qetësisë shpirtërore në zemrat e besimtarëve.** Ky është një nga objektivat më kryesore dhe më të rëndësishme të tregimeve kur'anore. Për të realizuar këtë qëllim, janë përmendur tregimet e profetëve me popujt e tyre. Shembull për këtë janë suret Hud, Jusuf, Nuh etj, ku rrëfimet e profetëve rrjedhin si uji i një burimi. Aty sqarohet se rruga e tyre (Paqja qoftë mbi ta) është e njëjtë, ndërsa e vërteta ka përkrahësit dhe kundërshtarët e saj. Në fund Allahu i Madhëruar ka sqaruar, se fitorja e profetëve dhe atyre që i ndjekin është absolute, pa marrë parasysh pengesat në rrugë, vështirësitë dhe sprovat e mëdha. Allahu (xh.sh) thotë: “Ne po t'i tregojmë ty disa nga historitë e të dërguarve, për të ta forcuar zemrën...”.⁸

Surja El-Kehf (Shpella)⁹ ka zbritur në Meke dhe ka 110 ajete. Dijetarët e islamit duke i studiuar dhe analizuar mësimet dhe porositë që përmban në vete kjo sure kanë thënë: “Në këtë sure ka zgjidhje, alternativa për të gjitha problemet që mund ta godasin muslimanin në çdo kohë. Ashtu siç ka qenë shpella strehim për ata djelmoshat edhe mësimet, mesazhet dhe porositë e kësaj sureje janë strehim (shpëtim) për ne”.

DISA VEÇORI TË KËSAJ SUREJE.

- Surja Kehf është njëra nga pesë suret që fillojnë me “Elhamdulillah” falënderimi i takon Allahut, e ato janë: El-Fatiha, El-En'am, El-Kehf, Sebe' dhe Fatir.

- Në këtë sure është fjala e mesit e Kur'anit. Fjala: “jetelattaf” (bëhu i butë) “Sillu mirë.”¹⁰

- Rrëfimet që tregohen në këtë sure nuk përsëriten në asnjë sure tjetër të kuranit.

- Leximi i sures Kehf është sunet i ditës së xhuma.

(vazhdon...)

7. Ali Imran, 93
8. Hud, 120
9. Surja mban këtë titull, sepse rrëfen historinë e Banorëve të Shpellës.
10. El-Kehf, 19.

Liria e njeriut nuk është përcaktim i pandryshuar, por ajo është kapacitet relativ, që pranon shtesë.

Paraditën e së mërkurës, më 4 shtator 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, ambasadorin e Shtetit të Kuvajtit në Tiranë, ShTZ. Fajiz Meshari El-Xhasim.

Gjatë takimit u diskutua mbi tema me interes të përbashkët, sikurse u theksua vlera e madhe e kontributeve kuvajtiane gjatë dekadave të fundit, si një dëshmi e bujarisë dhe bamirësisë së popullit kuvajtian, sidomos në vendin tonë.

U trajtuan këndvështrime me vlerë në drejtim të shfrytëzimit të vakëfit dhe domosdoshmëria e bashkëpunimit për realizimin e projekteve me vlerë dhe në interes të shoqërisë.

MYFTIU PRITI AMBASADORIN E KUVAJTIT



Paraditën e së shtunës, më 7 shtator 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një inspektim për të parë punimet që po kryhen për meremetimin e xhamisë së fshatit Boks, në zonën e Postribës.

Njëkohësisht, Myftiu ndoqi edhe një orë mësimi nga kursi i fundjavës, që zhvillohet në këtë xhami me fëmijët e fshatit, sipas programit të paracaktuar.

Myftiu falënderoi imamin e xhamisë, H. Agim Hoxha, sikurse uroi të pranishmit në kursin e Kur'anit për arritjet e tyre, përherë në rritje.

Meremetimet e xhamisë së fshatit Boks po realizohen në vazhden e marrëveshjes së Myftinisë Shkodër me Shoqatën "Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi".

MYFTIU INSPEKTOI PUNIMET NË XHAMINË E BOKSIT



RINISIN DERSËT JAVORE NË TË GJITHA XHAMITË E SHKODRËS

Paraditën e së mërkurës, më 11 shtator 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, diskutoi me imamët teologë mbi programin e derseve javore në xhamitë e Shkodrës.

Fillimisht, Myftiu u ndal tek realitetet e sotme shqiptare, ku tendenca e ekstremizmit dhe urrejtjes ndaj vlerave islame, sa vjen e shtohet, edhe me mbështetje politike dhe nga aktorë të ndryshëm të jetës publike në krejt trojet tona.

Myftiu tha se, përballë misionarëve të së keqes është e drejtë angazhimi i shumëfishtë dhe puna e pandërprerë në shërbim të Thirrjes Islame, larg egoizmit,



vetëkënaqësisë e provincializmit.

U diskutua vijimësia e programit të derseve javore, ku u caktuan angazhimet e reja të imamëve të nderuar, si dhe u dhanë udhëzime që lidhen me disiplinën

e imamit në detyrën e tij dhe raportet me institucionin dhe xhaminë.

Për ditën dhe oraret e derseve nëpër xhami shiko tabelën përkatëse në faqen e fundit të gazetës.

MYFTIU UROI MEDRESISTËT NË FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR

Paraditën e së hënës, më 16 shtator 2019, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në ceremoninë e fillimit të vitit të ri shkollor 2019 – 2020, në dy degët e Medresesë "Haxhi Sheh Shamia".

Fillimisht ai zhvilloi një vizitë në zyrën e drejtorit të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, të cilin e uroi duke u lutur për mbarësi e bekim.

Ai uroi njëkohësisht edhe stafin e medresesë së degës së djemve dhe drejtuesit e shoqatës "Istanbul", duke shprehur kënaqësinë e tij për arritjet e shkollës dhe duke kërkuar nga mësuesit përkushtim dhe korrektësi.

Myftiu tha se Medreseja e Shkodrës është një emër i madh, që na ngarkon të



gjithëve me përgjegjësi, sikurse është një amanet që duhet të përkujdesemi për respektimin e tij dhe përcjelljen tek brezi tjetër. Ai uroi edhe djemtë e vajzat,

që sot nisin vitin e ri shkollor 2019 – 2020, duke u lutur për mbarësi, bekim e rezultate të larta, që ndër vite na kanë bërë të ndjehemi krenarë!

"PËRJETIME DHE MBRESA NGA HAXHI 1440/2019"

Ditën e shtunë, më 21 shtator 2019, Myftinia Shkodër zhvilloi aktivitetin tradicional: "Përjetime Haxhi 1440/2019", në nderim të haxhilerëve të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe, që këtë vit kryen adhurimin e haxhit në vendet e shenjta.



Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, Drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, imamë e këshilltarë, haxhilerë ndër vite dhe haxhilerët e këtij viti.

Në mesazhet e dhëna nga teologët e nderuar, Altin Nikshiqi, Lavdrim Hamja, Arben Halluni, Ervil Kuçi, Vullnet Bega, si dhe haxhilerët e nderuar, H. Skënder Dizdari, H. Hadi Hoxha dhe H. Adem Zenelaj, u vlerësuan momentet më të spikatura të udhëtimit të mrekullueshëm të Haxhit 1440/2019, si dhe emocionet e shumta të këtij udhëtimi të paharruar.

Më herët, Myftiu i Shkodrës dhe ai i Malësisë së Madhe, dhanë mesazhet e tyre drejtuar haxhilerëve të këtij viti, si dhe urimet e përzemërta për pranimin e tij.

13 HAFIZË TË KUR'ANIT I SHTOEN VENDIT TONË

Pasditën e së mërkurës, më 25 shtator 2019, në ambientet e xhamisë së Parrucës u zhvillua ceremonia e promovimit të 13 hafizëve të rinj të Kur'anit Famëlartë, si pjesë e punës së palodhshme të Qendrës së Memorizimit të Kur'anit Famëlartë, pranë Medresesë "Haxhi Sheh Shamia".



Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Kryetari i Shoqatës "Istanbul", z. Ridvan Seferaj.

I ftuar special i kësaj ceremonie të dëshmuar ishte edhe personaliteti i shquar islam nga Stambolli, Hoxha i nderuar, Osman Nuri Topbash, njëkohësisht "Qytetar Nderi" i Shkodrës.

Autori i mirënjohur i dhjetëra titujve të spikatur, mbajti një ligjëratë me dobi, ku u përqendrua te shpjegimi i disa ajeteve kur'anore, që kanë të bëjnë me vlerën dhe madhësinë e Kur'anit Famëlartë.

Aktiviteti u ndoq nga qindra besimtarë të ardhur edhe nga qytete të tjera të Shqipërisë, si dhe miq të nderuar të ardhur nga Turqia, Kosova, Mali i Zi, etj., që kishin tejmbushur xhaminë e Parrucës.

ERDOĞAN NË OKB: MUSLIMANËT JANË VIKTIMAT MË TË SHPESHTA TË GJUHËS SË URREJTJES!

Erdoğan tha se gjuha e urrejtjes është normalizuar nga politikanët populistë dhe media dhe se ajo nuk duhet të ngatërrohet me lirinë e mendimit.

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, tha se Turqia do të vazhdojë t'u prijë përpjekjeve efektive për të luftuar islamofobinë në rritje, racizmin dhe gjuhën e urrejtjes, raporton AA.

Erdoğan këto vlerësime i bëri gjatë aktivitetit të bashkëorganizuar nga Turqia dhe Pakistani me temë "Lufta kundër gjuhës së urrejtjes", në selinë e Kombeve të Bashkuara (OKB) në New York.

Ai tha se mbështesin idenë për krijimin e bazës së të dhënave në OKB në lidhje me gjuhën e urrejtjes.

"Turqia do të vazhdojë t'u prijë përpjekjeve efektive për të luftuar islamofobinë në rritje, racizmin dhe gjuhën e urrejtjes", theksoi presidenti turk, duke shtuar se kanë zhvilluar punime të rëndësishme gjatë kryesimit të tyre në Organizimin e Bashkëpunimit Islam (OBI).

"Feja islame është një fe e paqes. Lidhja e Islamit, fesë së paqes, me terrorizmin, është një shpifje e pamoralshme dhe e papranueshme", theksoi Erdoğan.



"Muslimanët janë viktimat më të mëdha të gjuhës së urrejtjes", shtoi ai.

Erdoğan tha po ashtu se gjuha e urrejtjes është normalizuar nga politikanët populistë dhe media dhe se ajo nuk duhet të ngatërrohet me lirinë e mendimit.

– "Kashmiri është shndërruar në burg të hapur"

Presidenti Erdoğan foli edhe lidhur me situatën në Xhammu Kashmir pasi India vendosi t'i heqë rajonit të kontestuar statusin e veçantë.

"Është pamundur të definohet dhe kuptohet pika në të cilën aktualisht India ka arritur për sa i përket Kashmirit.

Për momentin, Kashmiri thuajse është shndërruar në një burg të hapur", tha Erdoğan.

"Hyrjet dhe daljet thuajse janë ndaluar dhe unë tani nuk mund ta mendoj se çfarë aktesh të përgajshme do të ndodhin në atë rajon nesër", shtoi presidenti turk.

Rajoni Xhammu Kashmir i administruar nga India është përballur me një ngërç që prej 5 gushtit, kur qeveria indiane revokoi nënin 370 të kushtetutës indiane, e cila i jepte një status të veçantë.

Sipas disa grupeve për të drejtat e njeriut, përfshirë Amnesty International dhe Human Rights Watch, qindra njerëz, kryesisht udhëheqës politikë, janë ndaluar ose arrestuar nga autoritetet që kur qeveria indiane ndërmori masën.

Megjithatë, autoritetet indiane pretendojnë se kufizimet janë hequr në 90 për qind të rajonit.

India dhe Pakistani kontrollojnë pjesë të Kashmirit dhe e pretendojnë atë në tërësi. Kina kontrollon gjithashtu një pjesë të rajonit të kontestuar, por janë India dhe Pakistani ato që kanë zhvilluar dy luftëra mbi Kashmirin.

(www.mejdani.com)

TURQIA, PAKISTANI DHE MALAJZIA ME KANAL TELEVIZIV KUNDËR ISLAMOFOBISË

Islamabad

Kryeministri i Pakistanit, Imran Khan ka deklaruar se Turqia, Pakistani dhe Malajzia kanë vendosur të krijojnë një kanal të përbashkët televiziv në gjuhën angleze për të luftuar me vështirësitë që paraqet islamofobia, transmeton Anadolu Agency (AA).

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, kryeministri i Malajzisë, Mahathir Mohamad dhe kryeministri i Pakistanit, Imran Khan zhvilluan një takim trepalësh në New York ku ata ndodhen në kuadër të Asamblesë së 74-të të Përgjithshme të OKB-së.

"Presidenti Erdoğan, kryeministri Mahathir dhe unë në takimin trepalësh që zhvilluam sot, vendosëm që tre vendet tona bashkërisht të krijojmë një kanal televiziv në gjuhën angleze për të luftuar me vështirësitë që paraqet islamofobia dhe për të korrigjuar gjërat që dihen gabim rreth fesë tonë të lartësuar të islamit", ka thënë Khan në llogaribë e tij në rrjetin social lidhur me takimin.

Ai tha se në këtë mënyrë do të korrigjohen perceptimet e gabuara që kanë bashkuar personat kundër muslimanëve.



"Do të vendoset në veprim një media e veçantë për muslimanët ku do të shpjegohet në mënyrë të drejtë çështja e ofendimit ndaj vlerave fetare dhe ku do të prodhohen filma dhe seriale që shpjegojnë historinë e muslimanëve si dhe për të informuar dhe edukuar njerëzit", theksoi Khan.

(www.aa.com.tr)

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT MJEDË

PAK HISTORI:

- Xhamia Mjedë, ndodhet në Njësinë Administrative "Gur i Zi", zona Shkodër.

- Përbëhet prej rreth 400 familje. Fiset më të njohura janë: Babaj, Hasmegaj, Selmanimet, etj.

- Pas rilejimit të besimit islam në vendin tonë, xhamia Mjedë ka qenë ndër të parat xhami në Shkodër që është hapur, pikërisht në vitin 1992 ka funksionuar si faltore deri në 1995. Po në këtë vit ka përfunduar ndërtimi i xhamisë së parë të re. Ndërsa, në vitin 2015 Mjeda është bërë me xhaminë e dytë.

- Në këtë faltore dhe xhami nga viti 1992 deri më sot kanë shërbyer imam



dhe mësues të mejtepeve si: Halim Heta, Ilir Lugji, Ilir Gurbeti, Dritan Cukali dhe imami aktual, Asllan Babaj

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar afërsisht kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2019 është rreth 280 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadrin e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtep e mësim-besimit, drejtuesi i tij, teologu Arben

Halluni zhvilloi para pak kohëve një takim me nxënësit e kurseve fetare në xhaminë Mjedë.

Fillimisht, ai u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin, pikërisht përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi i dy dekadave Asllan Babaj, i cili me përkushtim të vazhdueshëm mirëmban këto veprimtari mjaft të rëndësishme edukative dhe arsimore.





KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPËRISE
MYFTINIA SHKODËR

LISTA E DERSEVE TË PËRHERSHME JAVORE NË XHAMITË KRYESORE TË SHKODRËS (3)

E HËNË:

XHAMIA PARRUCË, pas sabahut
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari**
Tema: “300 Hadithe”

XHAMIA RUS, pas sabahut
Ligjërues: **H. Fejzi Zaganjori**
Tema: “Tema të përgjithshme”

E MARTË:

XHAMIA PARRUCË, pas sabahut
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari**
Tema: “300 Hadithe”

XHAMIA E MEDRESESE, pas akshamit
Ligjërues: **H. Adil Cukali**
Tema: “Këshilla të përgjithshme”

XHAMIA TOPHANË, pas akshamit
Ligjërues: **H. Ferid Rrilla**
Tema: “Këshilla të përgjithshme”

XHAMIA DUDAS, pas akshamit
Ligjërues: **H. Adrian Uraj**
Tema: “Këshilla të përgjithshme”

E MËRKURË:

XHAMIA PARRUCË,
pas sabahut
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari**
Tema: “300 Hadithe”

XHAMIA PERASH,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Adem Pizga**
Tema: “Historia e Pejgamberëve”

XHAMIA KIRAS,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Ruzhdi Plangaj**
Tema: “Komentim hadithi”

E ENJTE:

XHAMIA TOPHANË, pas akshamit
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari** - Tema: “Të afuarit tek All-llahu”

E XHUMA:

XHAMIA “EBU BEKËR”, para xhumasë
Ligjërues: **H. Idmir Plaku**
Tema: “Akide”

XHAMIA PARRUCË, para xhumasë
Ligjërues: **H. Naim Drijaj**
H. Durim Kasemi
Tema: “Koment i ajeteve kur'anore”

XHAMIA E “DY VAJZAVE”, para xhumasë
Ligjërues: **H. Lavdrim Hamja**
Tema: “Rijadus-Salihin”

XHAMIA DËRGUT, pas akshamit
Ligjërues: **H. Altin Nikshiqi**
Tema: “Komentim hadithi”

E SHTUNË:

XHAMIA “EBU BEKËR”,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Gilman Kazazi**
Tema: “Koment i ajeteve kur'anore”

XHAMIA PARRUCË,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Durim Kasemi**
Tema: “Argumente të besimit”

XHAMIA E “DY VAJZAVE”,
pas akshamit
Ligjërues: **Imam Muhamed Sytari**
Tema: “300 Hadithe”

E DIËL:

XHAMIA PARRUCË,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Naim Drijaj**
Tema: “Tema të fikhut”

XHAMIA DËRGUT,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Ervil Kuçi**
Tema: “Koment i ajeteve kur'anore”

XHAMIA KIRAS,
pas akshamit
Ligjërues: **H. Ruzhdi Plangaj**
Tema: “Tema të fikhut”

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org